



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS**

**RAPORT AUDITIMI PERFORMANCE**

**“Garantimi i mbrojtjes së të drejtës së autorit”**

**Tiranë, 2023**

# P Ë R M B A J T J A

<b>PËRMBLEDHJA</b> .....	<b>4</b>
<b>PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDIMIT</b>	<b>5</b>
1.1 Konteksti i problemit social.....	5
1.2 Rëndësia e auditimit të performancës.....	5
1.3 Auditime të mëparshme apo aktuale në këtë fushë.....	6
<b>SUBJEKTI/ET NËN AUDITIM</b> .....	<b>6</b>
2.1 Hyrje në subjektet nën auditim.....	6
2.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim.....	10
2.3 Rëndësia e produkteve të subjektit.....	11
2.4 Pesha në buxhet.....	11
2.5 Përkufizimet dhe terminologjia.....	13
2.6 Skema e analizës së programit auditees.....	14
2.7 Feedback-u i subjektit në fazën studimore.....	15
<b>DETAJET E AUDITIMIT</b> .....	<b>15</b>
3.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit.....	15
3.2 Objektivi i auditimit.....	17
3.3 Pyetjet e auditimit.....	18
3.4 Fushëveprimi i auditimit.....	19
<b>SHTJELLIMI I PYETJEVE AUDITUESE</b> .....	<b>19</b>
4.1 A është i përshtatshëm kuadri rregullator për mbrojtjen e të drejtës së autorit?.....	19
4.2.1 Si ka funksionuar mekanizmi i ngritur për administrimin kolektiv të së drejtës së autorit?.....	29
4.2.2 A ka qenë efektiv procesi i mbikëqyrjes së administrimit kolektiv?.....	43
4.3 A ka funksionuar koordimi dhe inspektimi ndërmjet DDA, AMA ISHMT?.....	48
<b>SHTOJCAT</b>	<b>52</b>

## Lista e shkurtimeve

<b>Nr.</b>	<b>Shkurtimi</b>	<b>Emërtimi i Plotë</b>
1	<b>RSH</b>	Republika e Shqipërisë
2	<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
3	<b>KLSH</b>	Kontrolli i Lartë i Shtetit
4	<b>VKM</b>	Vendim i Këshillit të Ministrave
5	<b>MK</b>	Ministria e Kulturës
6	<b>KKDA</b>	Këshilli Kombëtar i të Drejtës së Autorit
7	<b>DDA</b>	Drejtoria për të Drejtën e Autorit
8	<b>AMA</b>	Autoriteti i Mediave Audiovizive
9	<b>AAK</b>	Agjencia e Administrimit Kolektiv
10	<b>SUADA</b>	Sporteli Unik i Administrimit të të Drejtës së Autorit
11	<b>ISHMT</b>	Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut
12	<b>SWOT</b>	Fuqitë, Dobësitë, Shanset, Kërcënimet
13	<b>INTOSAI</b>	The International Organization of Supreme Audit Institutions
14	<b>EUROSAI</b>	The European Organisation of Supreme Audit Institutions
15	<b>PKIE</b>	Plani Kombëtar për Integrimin Evropian
16	<b>ALSIP</b>	Projekti shqiptaro-zviceran në fushën e pronësisë intelektuale
17	<b>PI</b>	Pronësia intelektuale
18	<b>SKZHI</b>	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
19	<b>KE</b>	Komisioni Evropian
20	<b>OBPI - WIPO</b>	Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale
21	<b>SKPI</b>	Strategjia Kombëtare e Pronësisë Intelektuale
22	<b>ZSHDA</b>	Zyra Shqiptare e të Drejtës së Autorit
23	<b>MSA</b>	Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit
24	<b>AKEP</b>	Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
25	<b>GNDIP</b>	Grupi Ndërinstitucional i Punës - MFE
26	<b>SDA</b>	Spektori i të Drejtës së Autorit, pranë ISHMT

## **PËRMBLEDHJA**

E drejta e autorit është një koncept ligjor, që mundëson krijimin e të drejtave të veçanta dhe kontrollin mbi përdorimin dhe kopjimin e punës kreative të autorëve nga përdoruesit. Këto të drejta përfshijnë: të drejtën e riprodhimit, të drejtën e ndarjes, si dhe të drejtën e përdorimit të punës në vlerë të ndërtuar. Kjo e drejtë nxit krijimtarinë, pasi përveç njohjes së autorësisë, motivimit financiar, garanton edhe mbrojtjen e veprave të autorëve nga kopjimi dhe përdorimi i paligjshëm.

E drejta e autorit, si institut juridik, në vendin tonë njihet që me Kodin Civil të vitit 1929 dhe deri më sot, me Ligjin nr.35/2016 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, të ndryshuar, i cili garanton një rregullim dhe mbrojtje më të plotë për këtë të drejtë, duke përcaktuar Ministrinë e Kulturës, si institucion përgjegjës në këtë fushë.

Politikat për të drejtën e autorit përfshihen në strategjitë kombëtare të pronësinë intelektuale (SKPI), ku institucion lider është Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Intelektuale, pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, e cila në fushën e vet të përgjegjësisë ka Pronësinë Industriale dhe mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale.

Në strategjitë e sipërpërmendura, Drejtoria për të Drejtën e Autorit, evidentohet me një rol dytësor, edhe pse ka detyrimin ligjor për, hartimin, zbatimin e strategjisë dhe politikave të duhura për mbrojtjen e të drejtës së autorit<sup>1</sup>.

Në mungesë të një strategjie të dedikuar për të drejtën e autorit, si dhe mosparashikimin e saj në Strategjinë Kombëtare për Kulturën 2019-2025, vizioni i synuar nga Ministria e Kulturës për të drejtën e autorit, rezulton me objektiva pjesërisht të realizuara. Kjo kërkon krijimin e një kuadri të gjerë dhe të integruar politikash, të cilat duhen të ndërmerren nga kjo ministri dhe institucionet përgjegjëse.

Përafrimi i vonuar me direktivat e BE – së, paqartësitë ligjore në kuadrin rregullator ekzistues, mungesa e marrëveshjeve dhe koordinimit ndërinstytucional, kanë shkaktuar mbivendosje kompetencash midis institucioneve përgjegjëse, lidhur me administrimin, monitorimin/inspektimin, si dhe fushën e zbatimit të së drejtës së autorit.

Administrimi kolektiv i të drejtave të autorit, kryhet nga agjencitë (AAK) e licencuara nga Ministria e Kulturës dhe Sporteli Unik (SUADA), nën mbikëqyrjen e Drejtorisë për të Drejtën e Autorit, e cila deri më sot funksionon me strukturë jo të plotë.

Gjatë periudhës objekt auditimi, aktiviteti i këtyre agjencive rezulton jo efektiv dhe me problematika, si më poshtë:

- mosrespektim të detyrimeve ligjore lidhur me licencat, ndryshimet statutores dhe kontratat;
- mosrishikim të metodologjisë dhe masës së tarifave të shpërblimeve për mbajtësit e të drejtës, që prej vitit 2017;
- nivel të ulët shpërndarjesh të shpërblimeve;
- tejkalim të kostove të administrimit, në raport me nivelin e shpërndarjeve;
- mungesë transparence dhe besueshmërie ndërmjet autorëve dhe agjencive;
- mungesë gjurmimi dhe evidentimi të përdoruesve të veprave, etj.

Drejtorja për të Drejtën e Autorit, në raporte monitorimi ka evidentuar parregullsi të përsëritura gjatë ushtrimit të aktivitetit të AAK – ve, por në moszbatim të legjisllacionit në fuqi, nuk ka propozuar masa, për pezullim apo heqjen e licencave të tyre.

---

<sup>1</sup> Germa a), pika 2 e nenit 157 e Ligjit nr. 35/2016 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar.

# 1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDITIMIT

## 1.1 Konteksti i Problemit Social

E drejta e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të, si objekte të së drejtës të rregulluara dhe të garantuara me norma juridike, janë relativisht të reja jo vetëm në Shqipëri, por edhe në botë.

Në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut citohet: “Gjithkush ka të drejtë të mbrojë interesat morale dhe materiale që rrjedhin nga çdo krijimtari artistike, shkencore dhe letrare, autor i të cilave është ai vetë”<sup>2</sup>. Kjo e drejtë është thelbësore për krijimtarinë njerëzore, duke u dhënë nxitje krijuesve jo vetëm nëpërmjet njohjes por dhe shpërblimit ekonomik të aktivitetit të tyre krijues, si dhe garanton që veprat e tyre mund të shpërndahen pa frikën e kopjimit të paautorizuar dhe piraterisë.

Në fund të shekullit të XVIII, autorët u ndërgjegjësuam për të drejtat pasurore të tyre, si rezultat i ndërthurjes së autorësisë me komercializmin dhe për herë të parë e drejta e autorit u njoh dhe u rregullua me ligj, veçanërisht e drejta e autorëve dhe e krijuesve.

Në vendin tonë, kjo e drejtë, si pjesë përbërëse e një legjislacioni më të gjerë të quajtur pronësia intelektuale, garantohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe mbrohet me Ligjin nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”<sup>3</sup>.

Me ratifikimin në parlament të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, miratuar me Ligjin nr. 9590, datë 27.07.2006<sup>4</sup>, Shqipëria detyrohej që brenda katër viteve, pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, të merrte masat e nevojshme për të garantuar një nivel mbrojtjeje të të drejtave të pronësisë intelektuale, të njëjtë me atë që ekziston në BE, përfshirë mjetet e efektshme për realizimin e këtyre të drejtave për harmonizimin e legjislacionit kombëtar me atë të BE në të gjitha degët e së drejtës.

Në sistemin tonë të së drejtës, “*instituti i së drejtës së autorit*” është edhe më i vonë, nga praktikat ligjore të botës së zhvilluar. Zbatimi i plotë i kësaj të drejte civile, nuk ka patur si të mos ishte i penalizuar nga “shtetëzimi” i të drejtave, prandaj dhe ndjeshmëria dhe ndërgjegjësimi qytetar për njohjen dhe respektimin e kësaj të drejte, rezulton me deficite, si në nivel shoqëror, ashtu dhe institucional.

Krijuesit e muzikës shqiptare, sikurse krijuesit e veprave artistike në përgjithësi, nuk kanë hezitur që dhe me deklarime publike të shprehin pakënaqësitë e tyre sa i përket:

- përditësimit dhe mosrespektimit të kuadrit rregullator;
- shpërndarjes së munguar të shpërblimit nga Sporteli Unik (SUADA);
- transparencës së munguar lidhur me aktivitetin e AAK-ve dhe SUADA-s;
- tejkalimit të kuotës të përcaktuar ligjërisht, në lidhje shpenzimet administrative, marrë nga shuma e shpërblimeve të të drejtës së autorit;
- mosdepozitimit të shpërblimeve të shpërndara në llogarinë e Ministrisë së Kulturës.

Në SKPI 2022-2026, referuar pyetësorit të zhvilluar nga OBPI-ja për agjencitë e administrimit kolektiv janë ngritur disa problematika, si: mbledhjet e AAK-ve janë në vlera të ulëta; AAK-të nuk kanë burimet e duhura financiare për të përballuar një kapacitet të burimeve njerëzore më të zgjeruar; metodologjia e tarifave e parashikuar; nevoja e intensifikimit të fushatave ndërgjegjësuuese; mungesa e bashkëpunimit mes AAK-ve; mungesa e besueshmërisë mes AAK-ve dhe përdoruesve,<sup>5</sup> etj.

Sfidë për zbatimin e plotë të së drejtës së autorit mbetet edhe një sistem koordinimi, monitorimi dhe inspektimi efektiv, ndaj operatorëve përdorues të veprave të muzikës shqiptare si nga DDA, ISHMT dhe AMA.

<sup>2</sup> Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, neni 27, paragrafi 2.  
<https://www.un.org/en/about-us/universal-declaration-of-human-rights>

<sup>3</sup> Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 58.

<sup>4</sup> Ligj nr. 9590, datë 27.07.2006 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare”, neni 73, pika 2.

<sup>5</sup> VKM Nr. 350, datë 26.05.2022 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale, 2022–2025”.

## **1.2 Rëndësia e auditimit të performancës**

Auditimet e performancës vlerësojnë nëse synimet e politikave dhe skemat qeverisëse lidhen me problemet reale të shoqërisë dhe shqetësimet e palëve të interesit, duke dhënë një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjithë projekteve dhe programeve në entet publike të audituara. Këto auditime kryhen duke u bazuar tek Standardet Ndërkombëtare ISSAI dhe Udhëzuesi i Auditimit të Performancës (ISSAI 300, 3000, 3100, 3200, 5100 dhe 5200), Manuali i Auditimit të Departamentit të Performancës, Indikatorët e Performancës sipas praktikave më të mira audituese, të cilat shërbejnë si udhërrëfyes për konceptimin, planifikimin, kryerjen, konkludimin dhe ndjekjen e rekomandimeve të auditimit të performancës. Këto dokumente përmbajnë një numër udhëzimesh dhe informacionesh që marrin në konsideratë kushtet specifike dhe karakteristikat e çdo auditimi performance. Kontrolli i Lartë i Shtetit, duke synuar realizimin e misionit të tij, si institucion që ofron një ekspertizë të pavarur në ndihmë të një menaxhimi sa më të përgjegjshëm në shërbim të qytetarëve, jep një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjitha projekteve dhe programeve të institucioneve dhe enteve publike të audituara. Nëpërmjet auditimit të performancës synohet të analizohet ekonomiciteti, eficiensa dhe efektiviteti i programeve të ekzekutivit.

Në linjë me prioritetet e përcaktuara në Strategjinë e Zhvillimit të KLSH-së 2023-2027, miratuar me Vendimin nr. 247 datë 29.12.2022 të Kryetarit, KLSH ndërmori auditimin “Garantimi i mbrojtjes së të drejtës së autorit”, si një ndër çështjet më thelbësore për krijimtarinë artistike, me synim informimin dhe nxitjen e krijuesve mbi zbatimin moral dhe material të kësaj të drejte. KLSH nëpërmjet këtij auditimi synon të paraqesë situatën aktuale në lidhje me politikat për mbrojtjen dhe administrimin e të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të si dhe efektivitetin e mekanizmit të ngritur në funksion të zbatimit të tyre. Në përfundim do të të jepen rekomandimet përkatëse për të përmirësuar situatën aty ku është e mundur.

## **1.3 Auditime të mëparshme apo aktuale në këtë fushë**

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në veprimtarinë e tij audituese gjatë viteve të fundit i ka kushtuar një rëndësi gjithmonë e më të madhe auditimit të veprimtarisë së institucioneve qendrore dhe atyre të varësisë sa i përket mbrojtjes së të drejtës së autorit në kushtet e zhvillimeve të fundit teknologjike përballë informalitetit në treg në vendin tonë.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, gjatë vitit 2015, ka realizuar auditimin me temë “Respektimi i të drejtës së autorit në Shqipëri”, pranë subjekteve Zyra Shqiptare për të Drejtën e Autorit dhe Autoriteti i Mediave Audiovizive, për periudhën 2012-2014.


## **2. SUBJEKTET NËN AUDITIM**

### **2.1 Hyrje në subjektet nën auditim**

Subjektet që do të përfshihen në këtë auditim janë:

1. Ministria e Kulturës.
  - Këshilli Kombëtar për të Drejtën e Autorit.
  - Drejtoria për të Drejtën e Autorit.
2. Autoriteti i Mediave Audiovizive.
3. Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut.

Skema 1. Skema e varësisë funksionale në MK.



*Burimi: Grupi i Auditimit*

### Ministria e Kulturës

Ministria e Kulturës, ka mision krijimin e një mjedisi të favorshëm për rritjen, zhvillimin e shërbimeve e produkteve kulturore dhe krijuese në sektorin publik/privat. Në përputhje me fushën e saj të përgjegjësisë shtetërore<sup>6</sup> si dhe kuadrin ligjor në fuqi<sup>7</sup>, kjo ministri siguron realizimin e regjistrimit, mbikëqyrjes dhe monitorimit të respektimit të të drejtave të autorëve dhe të drejtave të tjera të lidhura me to nga subjektet, personat fizikë/juridikë, privatë a publikë, përdorues të pronësisë letrare, artistike e shkencore.

### Këshilli Kombëtar për të Drejtën e Autorit

Këshilli Kombëtar për të Drejtën e Autorit (KKDA), miratuar me VKM nr.35, datë 18/01/2017<sup>8</sup>, ka kompetencat e mëposhtme:

- miraton metodologjinë dhe masën e tarifave të shpërblimit;
- vendos në lidhje me ndonjë pretendim të palëve për përfundimin e marrëveshjes dhe kontrollon nëse marrëveshja është në përputhje me parashikimet e këtij ligji;
- përcakton kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e krijimtarisë me vlerë kombëtare, sipas parashikimeve të këtij ligji;
- parashikon procedurat e arbitrazhit.

### Drejtoria për të Drejtën e Autorit

Drejtoria për të Drejtën e Autorit (DDA-ja), si strukturë pranë Ministrisë së Kulturës për të drejtat e autorit dhe të drejtat e lidhura me të ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- propozon, harton dhe zbaton strategjinë dhe politikën e duhur për mbrojtjen, ushtrimin dhe zbatimin e së drejtës së autorit, të drejtave të lidhura me të dhe të drejtave të tjera që mbrohen nga ky ligj, në përputhje me detyrimet ndërkombëtare, legjislationin vendas dhe interesat përkatës kombëtarë të Republikës së Shqipërisë;
- i paraqet ministrit përgjegjës për të drejtën e autorit dhe/ose institucioneve të tjera shtetërore

<sup>6</sup> VKM nr. 507, datë 13.09.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Kulturës”, i ndryshuar.

<sup>7</sup> Ligji nr. 35/2016

<sup>8</sup> VKM nr.35 datë 18/01/2017 “Për mënyrën e funksionimit, të organizimit dhe të shpërblimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit” (KKDA)

propozime, në rastin kur disa masa të nevojshme për zbatimin e strategjisë kombëtare të zbatimit të të drejtave të autorit, të përmendura në shkronjën “a”, të këtij neni, dalin jashtë kompetencave të saj;

ç) propozon akte ligjore lidhur me mbrojtjen, ushtrimin dhe zbatimin e së drejtës së autorit;

e) bashkëpunon me autoritetet kompetente administrative ose gjyqësore dhe çdo autoritet tjetër shtetëror kompetent për zbatimin e këtyre të drejtave të mbikëqyrjes së zbatimit të këtij ligji;

ë) kryen procedurat e shqyrtimit të dokumentacionit të organizatave për licencim, si AAK;

f) mbikëqyr veprimtaritë e AAK-ve dhe vepron në përputhje me parashikimet e këtij ligji;

g) krijon, administron dhe përditëson regjistrin e të dhënave, të hapur për publikun, dokumentar dhe elektronik, për:

i) regjistrimin vullnetar të krijimeve të mbrojtura nga e drejta e autorit;

iii) AAK-të e licencuara të administrimit kolektiv dhe veprimtarinë e tyre;

iv) subjektet përdoruese dhe pajisjen e tyre të detyrueshme me autorizimet, kontratat, autorizimet e lëshuara nga AAK-të, të licencuara në zbatim të këtij ligji;

i) kryen, me kërkesë dhe kundrejt pagesës, hetim administrativ, në favor të palëve të interesuara;

j) kryen çdo detyrë tjetër të përcaktuar në ligj.

DDA-ja funksionon si sekretariat teknik i KKDA-së dhe Bordit të Arbitrazhit, në zbatim të dispozitave të këtij ligji.

## **Organizmat që auditohen nëpërmjet DDA-së**

**Agjencitë e Administrimit Kolektiv (AAK)**, për llogari të mbajtësve të të drejtave dhe në bazë të kompetencave që u janë dhënë dhe sa parashikohet në Ligjin nr. 35/2016, kanë këto funksione:

- t'u japin përdoruesve, në vijim të kërkesave të tyre, kontrata në formën joekskluzive për përdorimin e veprave ose objekteve të të drejtave të lidhura, në këmbim të një shpërblimi, me kontratë të shkruar, brenda tagrave të përcaktuar në licencën e agjencisë;
- të mbledhin shpërblimin për përdorimin e veprave ose objekteve të të drejtave të lidhura;
- të shpërndajnë, në bazë të rregullave të shpërndarjes, shpërblimin e mbledhur nga përdoruesit në mënyrë të drejtë dhe të përpjesëtuar me vlerën dhe përdorimin aktual të veprave e të objekteve të të drejtave të lidhura. Parimet e shpërndarjes së shpërblimit përcaktohen në statutin e agjencisë dhe do të përjashtohet çdo mundësi arbitrariteti;
- të përfaqësojnë mbajtësit e të drejtave, të drejtat e të cilëve ata administrojnë, në procedurat gjyqësore ose administrative dhe të kryejnë çdo veprim tjetër ligjor të nevojshëm për mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave të administruara nga ato;
- të kryejnë çdo veprim tjetër, në përputhje me tagrat e tyre ligjorë dhe të organeve të veta vendimmarrëse, për kompetencat e marra nga mbajtësit e të drejtave;
- të hartojnë metodologji të negociueshme për përcaktimin e nivelit të tarifave që subjektet përdoruese duhet të paguajnë;
- të informojnë, sipas kërkesës, mbajtësit e të drejtave të autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhura me to për mënyrën e shfrytëzimit të të drejtave të tyre, për raportin vjetor financiar dhe atë të kontrollit të të ardhurave financiare, brenda kohës së parashikuar në statut;
- të sigurojnë transparencën e veprimtarisë së agjencisë së administrimit kolektiv, në lidhje me autoritetet publike të kontrollit, sipas ligjit;
- për të ardhurat e mbledhura nga përdoruesit dhe që u paguhet në formë shpërblimi mbajtësve të të drejtave, këto agjenci detyrohen të mbajnë dhe të paguajnë për llogari të administratës tatimore tatimin në burim, në përputhje me legjislacionin në fuqi për tatimin mbi të ardhurat;
- për efekt të përcaktimit të saktë të detyrimeve tatimore, kanë detyrimin të vënë në dispozicion të administratës tatimore, sipas formateve të miratuara, informacionin mbi të ardhurat e mbledhura nga përdoruesit e veprave të të drejtave të autorit/të lidhura me to, si dhe shpërndarjen e këtyre shpërblimeve të mbajtësit e të drejtave.

### **Ish - Sporteli unik për kryerjen e funksionit të mbledhjes së shpërblimeve – SUADA**

Misioni i “Sportelit Unik për Administrimin e të Drejtës së Autorit — SUADA” është mbledhja e tarifave të shpërblimit nga subjektet përdorues të veprës së mbrojtur në një sportel unik, në zbatim të vendimit të KKDA-së për miratimin e metodologjisë dhe masës së tarifave të shpërblimit në administrimin kolektiv.

**Sporteli unik – SUADA**, krijohet si subjekt juridik i regjistruar si organizatë jofitimprurëse në zbatim të legjislacionit në fuqi. Të gjitha AAK-të e licencuara janë anëtare në Këshillin Mbikëqyrës të “Sportelit Unik për Administrimin e të Drejtës së Autorit — SUADA”. SUADA ka detyrimin:

- të zbatojë ligjin e së drejtës së autorit dhe akteve nënligjore në zbatim të saj për dispozitat në lidhje me mbledhjen dhe shpërndarjen e tarifave të shpërblimit për sa këto dispozita janë të aplikueshme në funksion të transparencës, llogaridhënies dhe efikasitetit në veprimtarinë e saj.
- të realizojë mbledhjen kolektive të tarifave të shpërblimit nga subjektet përdorues në mënyrë efektive dhe t’i shpërndajë këto të ardhura tek AAK- të e licencuara në masën e parashikuar sipas Ligjit nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me to”.

### **Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA)**

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA ), krijuar me Ligjin nr. 97/2013, është autoriteti rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Funksionet kryesore të AMA-s janë:

- ✓ lëshimi dhe heqja e licencave dhe/ose autorizimet për ushtrimin e shërbimeve të transmetimit me shumicë të cilësuar;
- ✓ hartimi i strategjive për ofrimin e shërbimeve të transmetimit në Republikën e Shqipërisë;
- ✓ hartimi dhe miratimi i rregulloreve për procedurat dhe kriteret e dhënies së licencave dhe/ose autorizimeve, sipas përcaktimeve të këtij ligji;
- ✓ përcaktimi i pagesave për licencat;
- ✓ zgjidhja e mosmarrëveshjeve midis ofruesve të shërbimeve të transmetimeve audio ose audiovizive, përfshirë mosmarrëveshjet me transmetuesin publik;
- ✓ bashkëpunimi dhe këshillimi me AKEP-in, Autoritetin e Konkurrencës, Zyrën e të Drejtave të Autorit dhe organet e tjera në përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në Ligjin nr. 97/2013;
- ✓ miratimi i rregulloreve që synojnë zhvillim të qëndrueshëm për OSHMA-të;
- ✓ AMA kontrollon zbatimin e Ligjit nr. 97/2013 nga subjektet që ushtrojnë veprimtari në fushën objekt të këtij ligji;
- ✓ AMA monitoron tërësinë e programeve të transmetuara nga OSHMA-të;
- ✓ AMA sugjeron ndryshime të legjislacionit dhe të rregulloreve, të cilat diktohen nga zhvillimi teknologjik, ekonomik, social dhe kulturor në fushën e mediave audiovizive;
- ✓ AMA raporton në fillim të çdo viti për veprimtarinë vjetore të saj para Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik dhe para Kuvendit në seancë plenare.

### **Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT)**

Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, krijuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 36, datë 20/01/2016 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e ISHMT”, organizohet si Drejtori e Përgjithshme me juridiksion në të gjithë territorin e vendit dhe veprimtaria e tij


rregullohet me Urdhrin e Kryeinspektorit nr. 5122, datë 25/12/2017 “Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut”, të ndryshuar.

ISHMT-ja është përgjegjëse:

- ✓ për monitorimin e respektimit të të drejtave të pronësisë intelektuale, si dhe të drejtave të tjera, sipas fushës së veprimtarisë institucionale;
- ✓ për inspektimin e zbatimit të kërkesave të detyrueshme ligjore në fushën e garantimit të mbrojtjes dhe të respektimit të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, sipas përcaktimit të këtij ligji.

ISHMT bashkëpunon me çdo institucion përgjegjës zbatues dhe mbikëqyrës për respektimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura apo mbajtësve të ligjshëm të tyre dhe në çdo rast, objekti i kontrollit konsiston në produktin fizik dhe/ose në kontrollin e lejes së lëshuar nga mbajtësit e të drejtave ose agjencitë e licencuara të administrimit kolektiv, sipas parashikimeve të Ligjit nr. 35/2016.

Skema 2. Skema e njësisë së auditueshme në ISHMT.



*Burimi: Grupi i Auditimit*

## 2.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim

### 2.2.1 Kriteret politike:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
- Ligj nr. 35 datë 31/3/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar;
- Ligj nr. 9590, datë 27.7.2006 Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve evropiane e shteteve të tyre anëtare”;
- Ligji nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligj nr 10433, date 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- VKM nr. 507, datë 13.09.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Kulturës”, i ndryshuar;
- VKM nr. 607, datë 20.10.2021 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Kulturës”;
- VKM nr. 527 datë 20/7/2016 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale, 2016–2020”;

- VKM nr. 350 datë 26.05.2022 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale, 2022–2025;
- Plani strategjik i veprimit 2021-2023 AMA;
- VKM nr. 35 datë 18/01/2017 “Për mënyrën e funksionimit, të organizimit dhe të shpërblimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit ” (KKDA);
- VKM nr. 36, datë 20.1.2016 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut”, i ndryshuar;
- VKM nr. 34 datë 18/01/2017 “Për procedurat e regjistrimit, të organizimit dhe klasifikimit të veprave të të drejtave të autorit”;
- VKM nr. 33 datë 18/01/2017 “Për miratimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Drejtoria për të Drejtën e Autorit”;
- Etj.

### **2.2.2 Kriteret teknike dhe të monitorimit**

- Udhëzimi nr. 663 datë 10.10.2017 “Për mënyrën e funksionimit dhe të organizimit të Sportelit Unik për administrimin e të drejtës së autorit – SUADA në administrimin kolektiv”.
- Udhëzimi nr. 5166 datë 20/10/2016 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të tjera shtesë në sqarim të kriterëve të parashikuara në nenin 133, si dhe përcaktimin e kushteve dhe procedurës së marrjes së licencës ose ripërtëritjen e saj, në bazë të nenit 134, të ligjit nr.35, datë 31.3.2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar.
- Udhëzimi nr. 385, datë 13.10.2020 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për marrjen e licencës për administrimin kolektiv të të drejtave të autorit, ripërtëritjen e saj, si dhe përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për pezullimin dhe heqjen e licencës në zbatim të ligjit nr. 35, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to””, i ndryshuar.
- Urdhër nr. 5122, datë 25.05.2017 “Për miratimin e rregullores së brendshme të Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut”, i ndryshuar.
- Urdhër nr. 92 datë 16.04.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme të Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut”.
- Rregullore e Brendshme për Ministrinë së Kulturës.
- Manuali i Përkufizimeve në zbatim të Ligjit nr. 35/2016 “Për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e tjera të lidhura me to”.
- Memorandume;
- Etj.

### **2.3 Rëndësia e produkteve të subjektit**

Ligji nr. 35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, janë të rëndësishme pasi nëpërmjet sanksionimit të kriterëve juridike dhe administrative, ndihmojnë në rregullimin e marrëdhënieve që lindin midis të gjitha palëve, të cilat kanë për objekt krijimtarinë artistike muzikore, duke synuar mbrojtjen dhe administrimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura me të. Aktivitetet e subjekteve nën auditim, janë të orientuara drejt: regjistrimit të të drejtave mbi veprat artistike; shmangies së konkurrencës së pandershme; falsifikimit të autorësisë; monitorimit dhe inspektimit të tregut kundër përdorimit të paautorizuar të veprave me qëllim sigurimin e fitimeve të paligjshme, në shkëlqje të së drejtës së autorit.

Reflektimi në përmbajtjen e kuadrit rregullator aktual të *acquis communautaire*-n mbi të drejtën e autorit, përgjegjshmëria institucionale dhe transparencja janë kriterë të cilat garantojnë dhe evidentojnë nivelin e mbrojtjes të së drejtës së autorit.

## 2.4 Pesha në buxhet

### Ministria e Kulturës - Drejtoria për të drejtën e autorit (DDA)

Drejtoria për të Drejtën e Autorit (DDA) është strukturë e brendshme e Ministrisë së Kulturës, përgjegjëse për të drejtat e autorit dhe ushtron veprimtarinë në zbatim të Ligjit nr. 35/2016 “Për të drejtën e autorit dhe të drejta të tjera të tjera të lidhura me to”.

Buxhetet totale vjetore të Ministrisë së Kulturës për periudhën vitet 2019-2022 përfshijnë fondet për aparatin dhe institucionet në varësi të saj. Drejtoria për të drejtën e autorit, njësi e aparatit të MK përdor një pjesë të këtij buxheti. Buxhetet e realizuara në nivel ministrie dhe pesha që fondet për DDA zënë, sipas periudhës objekt auditimi, paraqiten si vijon:


Tabela nr. 1 Fondet Buxhetore të Ministrisë së Kulturës-DDA lekë

Nr.	Periudha	Fonde Buxhetore gjithsej Ministria e Kulturës	Fonde Buxhetore për DDA	Pesha e DDA në buxhetin e MK në (%)
		Fakt	Fakt	
1	Viti 2019	160,276,000	4,363,814	2.72%
2	Viti 2020	164,820,000	4,815,476	2.92%
3	Viti 2021	158,450,000	6,046,694	3.82%
4	Viti 2022	170,850,000	5,486,704	3.21%
<b>Shuma</b>		<b>654,396,000</b>	<b>20,712,688</b>	<b>3.165%</b>

Burimi: Ministria e Kulturës, përpunuar nga grupi i auditimit

Ecuria e realizimit të fondeve buxhetore nga Ministria e Kulturës – DDA, në periudhën vitet 2019-2022 dhe pjesa e fondeve të dedikuara për DDA, paraqiten grafikisht si vijon:

Grafiku nr. 1 Fondet Buxhetore të Ministrisë së Kulturës-DDA



Burimi: Grupi i auditimit

Përveç fondeve të alokuara nga buxheti i shtetit, Drejtoria për të Drejtën e Autorit përgjatë periudhës 2020-2022 ka qenë përfituese e dy projekteve të bashkëpunimit:

a) TWINNING Project AL17IPA FI0120 “Strengthening the Protection and the Enforcement of Intellectual Property Rights”.

b) ALSIP – projekti i bashkëpunimit mes Shqipërisë dhe Zvicrës për pronësinë intelektuale.

Të dy këto bashkëpunime kanë kontribuar në iniciativat e DDA-së për të ushtruar detyrën e saj në promovimin dhe organizimin e fushatave të ndërgjegjësimit të institucioneve, grupeve të interesit dhe publikut, si edhe aktiviteteve të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare, si seminare, konferenca

dhe trajnime, por nga DDA, nuk gjenerohet informacion mbi kostot financiare të këtyre dy projekteve.

### ISHMT-Sektori i të Drejtës së Autorit (SDA)

Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut është institucion qendror buxhetor në varësi të dyfishtë nga Inspektorati Qendror dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë. ISHMT organizohet në nivel qendror. Sektori i të Drejtës së Autorit (SDA), si njësi përbërëse e strukturës së ISHMT-së, përfiton nga fondet e alokuara për këtë Inspektorat. Për periudhën 2019-2022 fondet buxhetore të përdorura nga ISHMT-SDA paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 2 Fondet Buxhetore të ISHMT-SDA


lekë

Nr.	Periudha	Fonde Buxhetore gjithsej ISHMT	Fonde Buxhetore për SDA	Pesha e SDA në buxhetin e ISHMT në (%)
		Fakt	Fakt	
1	Viti 2019	63,220,450	9,213,856	14.57%
2	Viti 2020	73,794,260	10,065,209	13.64%
3	Viti 2021	94,199,351	11,195,768	11.88%
4	Viti 2022	94,775,814	10,511,336	11.09%
<b>Shuma</b>		<b>325,989,875</b>	<b>40,986,169</b>	<b>12.57%</b>

Burimi: ISHMT, përpunuar nga grupi i auditimit

Ecuria e realizimit të fondeve buxhetore nga ISHMT, në periudhën vitet 2019-2022 dhe pjesa që i takon SDA-së, paraqitet grafikisht si vijon:

Grafiku nr. 2 Fondet Buxhetore të ISHMT-SDA



Burimi: Grupi i auditimit

### AMA

Autoriteti i Mediave Audiovizive, si autoriteti rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë, e zhvillon aktivitetin në regjim vetëfinancimi, meqë burimet e financimit të saj janë: të ardhurat nga pagesat për marrjen dhe rinovimin e licencave dhe/ose autorizimeve; të ardhurat nga pagesat vjetore të licencave dhe/ose autorizimeve; të ardhurat nga përpunimi administrativ i kërkesave për aplikime; të ardhurat nga tarifat për shërbimet e transmetimeve të caktuara në ligjet fiskale, në rolin e agjentit tatimor; financime nga Buxheti i Shtetit; burime të tjera të ligjshme. AMA merr financim

nga Buxheti i Shtetit në rastet kur vlerëson se disa shpenzime janë të nevojshme për ushtrimin e funksioneve të saj, të një natyre të veçantë dhe për të cilat nuk ekziston mundësi tjetër financimi. Sikurse referuar nga AMA, për sa më sipër, vihet në dukje se: “AMA nuk ka pasur ndonjë angazhim buxhetor të drejtpërdrejtë për muzikën shqiptare por është investuar nëpërmjet ekspertëve të jashtëm për analizimin e gjendjes së filmit shqiptar. Ky studim është kryer në bashkëpunim me Observatorin Evropian Audioviziv”.<sup>9</sup>

## 2.5 Përkufizimet dhe terminologjia

Në kuptim të këtij auditimi, me termat e mëposhtëm nënkuptojmë:

1. “Vepër Artistike” është çdo krijim origjinal, intelektual i një personi fizik i materializuar, pavarësisht nga forma dhe mënyra e të shprehurit, që ka për qëllim të prekë ndjesitë e njeriut.
2. “Vepër artistike e prejardhur” është çdo krijim intelektual, i cili e ka prejardhjen nga një vepër origjinale, por pa e cënuar atë.
3. “Vepra audiovizuale” është vepra e cila prek tek njeriu shqisat e të parit dhe të dëgjuarit, që nënkupton një seri pamjesh, të lidhura dhe të vazhdueshme, të shoqëruara me tinguj, të regjistruara për tu shfaqur me anë të përdorimit të mjeteve të përshtatshme për përcjelljen e këtyre pamjeve dhe të tingujve.
4. “Ekspozim i një vepre artistike” nënkupton shfaqjen në publik në mënyrë të drejtpërdrejtë, kryesisht të një vepre origjinale.
5. “Vepër muzikore” nënkupton veprën artistike, të realizuar nga ndërthurja e tingujve me ose pa tekst, me vargje ose me libret, për tu ekzekutuar nga instrumente muzikorë, nga zëra njerëzorë dhe /ose nga të dyja së bashku.
6. “Origjinalitet i një vepre” nënkupton shfaqjen e botës së brendshme të një autori, pa kopjuar, në tërësi ose në një pjesë të rëndësishme, një krijim tjetër.
7. “Videogram” nënkupton mjedisin ku është fiksuar një vepër audiovizuale e materializuar me ose pa kolonë zanore që lejon përcjelljen a riprodhimin e veprës.
8. “Shirit videoje” është shiriti mbajtës i fiksimit audiovizual.
9. “Përcjellje me satelit” është çdo veprim ndërhyrje i sinjaleve mbajtëse të programit për marrjen nga publiku, në një zinxhir të pandërprerë përcjellje nga sateliti drejt tokës, nën kontrollin dhe përgjegjësinë e organizatës së transmetimit. Me përcjellje nënkuptohet prodhimi i sinjaleve përcjellëse të destinuara për satelit, kur marrja e këtyre sinjaleve nga publiku mundësohet vetëm nga një organizatë transmetuese, por jo nga organizata fillestare.
10. “Transmetimi kabllor ose me anë të kabllit” nënkuptohet transmetimi i pandërprerë, i vazhdueshëm e në të njëjtën kohë me anë të kabllit ose me anë të sistemit të transmetimit të mikrovalëve, i programit të radios dhe të televizionit për t'u kapur nga publiku me anë të fijeve ose pa fije.


## 2.6 Skema e analizës së programit auditues

Ky auditim do të fokusohet në analizimin e politikave për mbrojtjen dhe administrimin me efektivitet të të drejtës së autorit dhe të drejtat e lidhura me to, monitorimin si edhe rolin dhe përgjegjësitë që subjektet nën auditim kanë patur duke u fokusuar veçanërisht në:

- Misionin e Ministrisë së Kulturës lidhur me mbrojtjen e të drejtës së autorit;
- Hartimin e politikave që mbrojnë të drejtën e autorit;
- Rolin dhe përgjegjësitë e strukturave që lidhen me administrimin e të drejtës së autorit;
- Fondet buxhetore që dedikohen për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me të;
- Koordinimi dhe bashkëpunimi midis institucioneve;
- Sistemin e raportimit dhe monitorimit/inspektimit së të drejtës së autorit.

<sup>9</sup> Përgjigje e dhënë Grupit të Auditimit nga AMA me e-mail, datë 26.05.2023.

Skema nr. 3. Skema e analizës së programit auditues.



## 2.7 Feedback-u i subjekteve gjatë auditimit

Gjatë fazës studimore, Ministria e Kulturës, AMA dhe ISHMT, i janë përgjigjur përgjithësisht në kohë takimeve prezantuese dhe konsultuese si edhe plotësimit të informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar që lidhet me vjeljen e të dhënave paraprake dhe gjatë fazës studimore në lidhje me kërkesat e grupit të auditimit.


## 3.DETAJET E AUDITIMIT

### 3.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit

Risqet e politikave dhe aktiviteteve të subjekteve të përfshira në këtë auditim, kanë të bëjnë me vështirësitë dhe pengesat që ato hasin në realizimin e detyrave dhe funksioneve të përcaktuara në kuadrin ligjor e rregullator në fuqi. Për të kryer analizën e riskut, jemi mbështetur në analizën SWOT, e cila është një kornizë që përdoret për të identifikuar dhe analizuar fuqitë, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet që paraqiten lidhur me çështjen që trajtohet. Analiza SWOT është e dizenuar për të ofruar një qasje realiste, të bazuar në fakte dhe të dhëna e cila përdor burime të brendshme dhe të jashtme dhe përdoret si një teknikë për të vlerësuar performancën, risqet dhe mundësitë potenciale për zhvillim dhe arritjen e objektivave. U përzgjedh përdorimi i analizës

SWOT nisur nga fakti që kjo analizë ofron mundësinë e një menaxhimi më efikas të një problemi kompleks siç është mbrojtja e të drejtës së autorit. Referuar analizës SWOT, grupi i auditimit ka bërë një ndarje dhe grupim të risqeve të veprimitarisë së institucioneve përkatëse dhe kategorizimin e tyre në strategjike, financiare, juridike dhe operationale.

Skema nr. 4. **Analiza SWOT**



*Burimi: Grupi i auditimit*

Tabela. 3: Analiza e Riskut

Nr.	Risku i Subjektit	Kategorizimi i riskut	Niveli i Riskut
1	Përfshirja e të drejtës së autorit në një strategji me PI	<b>Risk Strategjik</b>	I lartë
2	Mungesë analize për planifikimin e fondeve buxhetore.	<b>Risk financiar</b>	I mesëm


3	Kuadri rregullator i parishikuar, mungesë aktesh nënligjore	<b>Risk Rregullator dhe Juridik</b>	I lartë
4	Reforma strukturore të paanalizuara paraprakisht		
5	Koordinim dhe bashkëpunim ndërinstytucional i dobët	<b>Risk Operacional</b>	I lartë
6	Administrim joefektiv për shkak të roleve dhe kompetenca të paqarta midis institucioneve të përfshira në proces		I mesëm
7	Mungesë e sistemit të raportimit dhe monitorimit.		I mesëm
8	Mosfeksionimi i sistemit TIK dhe logjistika e mangët		I lartë
9	Aktiviteti i DDA i paaudituar		I lartë

*Burimi: Grupi i Auditimit*

### 3.2 Objektivi i auditimit

Auditimi me temë “Garantimi i mbrojtjes së të drejtës së autorit” ka si objektivi kryesor vlerësimin e politikave të ndërmarra nga institucionet përgjegjëse dhe efektivitetin e tyre në funksion të garantimit dhe miradministrimit të saj. Në këtë mënyrë do të synohet të sigurohet një vlerësim i paanshëm dhe objektivi nëse politikat e ndërmarra, rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve janë të qarta si dhe proceset administrative garantojnë miradministrimin e mbrojtjes së të drejtave të autorit.

### 3.3 Pyetjet e auditimit



### 3.4 Fushëveprimi i auditimit

Ky auditim do të ketë si fushëveprimi analizimin dhe dhënien e një opinioni mbi politikat e ndërmarra dhe miradministrimin e proceseve me synim garantimin e të drejtës së autorit. Auditimi për shkak të kompleksitetit të tij do të ketë një qasje në nivel makro, nisur nga perspektiva e detyrimeve ligjore që institucionet e përfshira në mbrojtjen e të drejtës së autorit, kanë në lidhje me përfituesit e drejtpërdrejtë të kësaj të drejte (autorët).

Periodha e auditimit do të jetë 01.01.2019 deri më datë 31.12.2022. Gjatë këtij auditimi do të fokusohemi në mënyrë të veçantë në veprimtarinë e Ministrisë së Kulturës, Drejtorisë për të Drejtën e Autorit, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut dhe Autoriteti i Mediave Audiovizive. Agjencitë e Administrimit Kolektiv dhe Sporteli Unik për Administrimin e së Drejtës së Autorit do të auditohen tërthorazi nëpërmjet të dhënave që do të gjenerohen nga Drejtoria për të Drejtën e Autorit, duke qenë se kanë statusin e OJF-ve.

Numri i lartë i subjekteve të përzgjedhur si edhe periodha e auditimit prej vitit 2019 do të ofrojnë një panoramë më të plotë lidhur me politikat dhe aktivitetet reale që institucionet përgjegjëse ushtrojnë në funksion të përmbushjes së objektivave për garantimin e të drejtës së autorit.

## 4. Shtjellimi i pyetjeve audituese

### Pyetja Kryesore: A garantohet mbrojtja e të drejtës së autorit?

Mesazhi i auditimit

Ministria e Kulturës, institucionet shtetërore dhe organizatat joqeveritare, duhet të rrisin më shumë bashkëveprimin për, mbrojtjen, promovimin dhe garantimin e të drejtës së autorit nëpërmjet, forcimit të legjislacionit, harmonizimit të praktikave më të mira ndërkombëtare dhe marrjen e masave ligjore, nëse vepra e tij kopjohet, përdoret pa leje, ose shkelet ndonjë aspekt tjetër.

E drejta e autorit në vendin tonë, vijon të ketë paqartësi ligjore në kuadrin rregullator ekzistues të cilat kanë sjellë objektiva pjesërisht të realizuara. Përafrimi i vonuar me direktivat e BE – së, mungesa e një strategjie të dedikuar, mungesa e marrëveshjeve dhe koordinimit ndërinstitucional, kanë shkaktuar mbivendosje kompetencash midis institucioneve përgjegjëse, lidhur me administrimin, monitorimin/inspektimin, tejkalimin e kostove të administrimit të Agjencive të Administrimit Kolektiv të të Drejtave, në raport me nivelin e shpërndarjeve të shpërblimeve tek mbajtësit e të drejtave të autorit. Mosrespektimi i detyrimeve të licencave të Agjencive të Administrimit Kolektiv, mungesa e transparencës dhe besueshmërisë ndërmjet autorëve dhe agjencive, mungesa e gjurmimit dhe evidentimit të përdoruesve të veprave, nuk garantojnë administrim korrekt dhe mbrojtje efektive të së drejtës së autorit.

### 4.1 A është i përshtatshëm kuadri rregullator për mbrojtjen e të drejtës së autorit?

#### *Kuadri strategjik i të Drejtës së Autorit*

Rregullimi ligjor i të drejtës së autorit nuk është vetëm një aspekt i së drejtës kombëtare të çdo shteti, por mbrojtja e kësaj të drejte ka marrë përmasa ndërkombëtare, duke u bërë kështu objekt i rregullimit normativ edhe nga marrëveshjet ndërkombëtare. Sipas këtij sistemi të drejtash, krijuesit janë të siguar që veprat e tyre mund të shpërndahen pa frikën e kopjimit të paautorizuar dhe piraterisë.

Zhvillimi historik i të drejtës së autorit në Shqipëri ka njohur disa faza, duke filluar nga Kodi Civil i vitit 1929, që shënon fillimet e para, Kodi i vitit 1981, ku në nenet 315-335 garantohej mbrojtja e kësaj të drejte, jo vetëm për veprat origjinale por edhe ato të prejardhura, duke parashikuar se subjekte të së drejtës së autorit do të quhen edhe ata që krijojnë veprat e prejardhura si përshtatjet, përkthimet, ekranizimet, si dhe çdo transformim të veprave letrare, muzikore e të tjera.

Ky Kod i shtriu efektet juridike deri në vitin 1992, me aprovimin e Ligjit nr. 7564, datë 19.05.1992 “Për të drejtën e autorit”, ndryshuar me Ligjin nr. 7932, datë 19.04.1995, i ndryshuar, në vazhdimësi me ligje të tjera dhe plotësuar me akte nënligjore.

E drejta e autorit është sanksionuar si një e drejtë themelore e njeriut në Kushtetutën e Shqipërisë, në të cilën përcaktohet se *“Liria e krijimit artistik dhe e kërkimit shkencor, vënia në përdorim, si dhe përfitimi prej arritjeve të tyre janë të garantuara për të gjithë. Kjo e drejtë e autorit mbrohet me ligj”*

Në vitin 2005, u aprovua Ligji “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera fqinje të lidhura me të”, i ndryshuar, dhe më pas Ligji nr. 35/2016 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, ndryshuar, i cili garanton një rregullim dhe mbrojtje më të plotë për këtë institut.

Angazhimi i vendit tonë drejt integritimit evropian kërkon qeverisje të mirë, e cila nëpërmjet programeve qeverisëse të konceptuara si plane të kujdesshme veprimi, synon realizimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, për të garantuar dhe përmirësuar cilësinë e jetës së qytetarëve.

Nisur nga fakti, se zbatimi efikas i të drejtës së autorit është një element thelbësor për progresin e mëtejshëm social-ekonomik të vendit, si dhe për garantimin e një mjedisi konkurrence të lirë në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar, është e nevojshme të ndërgjegjësohen të gjithë për rëndësinë e tij.

Ministria e Kulturës, në parashikimet e qarta të Ligjit nr. 35/2016 të ndryshuar, përcaktohet si institucioni përgjegjës për garantimin dhe mbrojtjen e të drejtës së autorit.

Me miratimin e Strategjive Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2016–2020<sup>10</sup> dhe SKPI 2022-2025<sup>11</sup>, Qeveria Shqiptare ka shprehur vizionin drejt një sistemi më të fortë të pronësisë intelektuale, me synim mbrojtjen efektive të saj, duke inkurajuar krijimtarinë dhe inovacionin në shërbim të rritjes ekonomike dhe zhvillimit kulturor dhe shkencor në Republikën e Shqipërisë<sup>12</sup>.

Bazuar në legjislacionin aktual<sup>13</sup>, Drejtoria për të Drejtën e Autorit, propozon, harton dhe zbaton strategjinë dhe politikën e duhur për mbrojtjen, ushtrimin dhe zbatimin e së drejtës së autorit, të drejtave të lidhura me të dhe të drejtave të tjera që mbrohen nga ky ligj, në përputhje me detyrimet ndërkombëtare dhe interesat përkatës kombëtarë të Republikës së Shqipërisë. Ministria e Kulturës, ka tagrin ligjor për zbatimin e administrimit të drejtës së autorit në RSH.

Pronësia intelektuale është një kategori pronësie, e cila përfshin Pronësinë Industriale dhe të Drejtën e Autorit, që është përcaktuar në Ligjin nr. 8993, datë 30.1.2003 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën për themelimin e organizatës botërore të pronësisë intelektuale”, Shqipëria është bërë anëtare e WIPO-s.<sup>14</sup>

E drejta e autorit trajtohet në kuadër të pronësisë intelektuale, ku aktori kryesor është Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Intelektuale, ndërkohë që Drejtoria për të Drejtën e Autorit shfaqet si një institucion dytësor. Si i tillë, ky status i dhënë DDA-së, nga Strategjia e Pronësisë Intelektuale, rezulton i tjetërsuar, në raport me përcaktimet e bëra nga ligji, mbi rolin dhe përgjegjësitë e kësaj drejtorie, duke e trajtuar DDA-në si një institucion dytësor për nga rëndësia, në kundërshtim me statusin që ligji i njeh. Në këto kushte realizimi i objektivave politikë është përtej punës teknike të DDA-së.

Pavarësisht se ligji e ngarkon, DDA-ja nuk harton një strategji të vetën, ad-hoc për mbrojtjen e të drejtës së autorit. Për më tepër e drejta e autorit nuk është e parashikuar as në Strategjinë e

<sup>10</sup> file:///C:/Users/Soni/Downloads/Strategjia-Kombëtare-e-Pronësisë-Intelektuale-2016-2020%20(1).pdf

<sup>11</sup> VKM nr. 350, datë 26.5.2022 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale”.

<sup>12</sup> Raporti i Rekomandimeve dhe i Vlerësimit të Sistemit të PI - WIPO

<sup>13</sup> Germa a) e pikës 2 të nenit 157 të Ligjit nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, të ndryshuar

<sup>14</sup> “Pronësia Intelektuale” përfshin të drejtat në lidhje me:

- veprat letrare, artistike dhe shkencore,
- shfaqjet artistike, fonogramat dhe transmetimet,
- shpikjet në të gjitha fushat e veprimtarisë njerëzore,
- zbulimet shkencore,
- disenjot industriale,

- markat tregtare, markat e shërbimit, emrat tregtarë dhe emërtimet e origjinës, mbrojtjen kundër konkurrencës së pandershme dhe të gjitha të drejtat e tjera që rezultojnë nga aktiviteti intelektual, në fushat industriale, shkencore, letrare ose artistike.

Ministrisë së Kulturës, me role specifike dhe të mirë detajuara, duke lënë jashtë fokusit të saj rolin dhe përgjegjësinë që ligji i ngarkon kësaj drejtorie.

DDA është aktor në përmbushjen e objektivave të Strategjive Kombëtare të Pronësisë Intelektuale, për të drejtën e autorit arritja e të cilave realizohet në bashkëpunim me strukturat drejtpërdrejtë të përfshira në të.

Pavarësisht spektrit të gjerë të aktivitetit që kjo drejtori zhvillon duke filluar që nga regjistrimi, licencimi, monitorimi i administrimit kolektiv të së drejtës së autorit, aspekti më thelbësor me të cilin e ngarkon ligji, është hartimi dhe zbatimi i strategjive dhe politikave të duhura, për mbrojtjen e të drejtës së autorit.

Për periudhën 1 janar 2021-26.05.2022, nuk ka patur strategji për Strategji Kombëtare për Pronësinë Intelektuale, pasi siç përmendet, në përgjigjet e pyetësorëve drejtuar Drejtorisë për të Drejtën e Autorit, institucioni lider i hartimit të kësaj strategjie është Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe sekretariati teknik (lider i grupit ndërinstitucional) është Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Intelektuale. Si e tillë, Drejtoria për të Drejtën e Autorit shprehet se nuk ka qenë në dijeni të problematikave të evidentuara gjatë periudhës 1 janar 2021-26.05.2022, megjithatë referuar përcaktimeve ligjore objekti i veprimtarisë së kësaj drejtorie është hartimi i politikave dhe strategjive për të drejtat e autorit.

Me Ligjin nr. 8993, datë 30.1.2003 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën për themelimin e organizatës botërore të pronësisë intelektuale”, Shqipëria është bërë anëtare e WIPO-s.<sup>15</sup>

Nga grupi i auditimit është konstatuar se në raportin e rekomandimeve të WIPO ( Organizata Botërore për Pronësinë Intelektuale), në SKPI 2016-2020 dhe SKPI 2022-2025, citohet rekomandimi: “Bazuar në vlerësimin e situatës, do të ishte e rekomandueshme, për arsyet e efektivitetit dhe eficiencës, të merret parasysh, nëse bashkimi i DPPI-së dhe Drejtorisë së të Drejtave të Autorit në një organ administrativ, do të çonte në shërbime dhe aktivitete më të mira dhe funksionalitet më të mirë të të gjithë sistemit të pronësisë intelektuale. Kjo mund të kursejë kostot operacionale dhe të sigurojë koordinim më të mirë të të gjithë sistemit”<sup>16</sup>.

Ky rekomandim është i një natyre sugjeruese dhe jo urdhëruese dhe reflektimi i tyre në SKPI është i nevojshëm, megjithatë ky raport është përfshirë në VKM nr. 350, datë 26.5.2022 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale”.

Drejtorisë së të Drejtave të Autorit në përgjigjet e saj zyrtare ka shprehur jo dakordësi lidhur me këtë rekomandim. Në përgjigjet e pyetësorëve të Grupit të Auditimit, kjo drejtori shprehet se propozimi për bashkimin e saj me Drejtorinë e Përgjithshme e Pronësisë Intelektuale është ligjërish jo i përshtatshëm, për faktin se objekti i veprimtarisë së kësaj drejtorie është e drejta e autorit. Kjo drejtori është shprehur se roli i saj nuk është i mirë përcaktuar, në dokumentet strategjike.

Nga auditimi konstatohet se Drejtoria e të Drejtës së Autorit, Inspektorati Shtetëror i Tregut dhe Autoriteti i Medias Audiovizuale raportojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme e Pronësisë Intelektuale pranë Ministrisë Financave dhe Ekonomisë, mbi nivelin e zbatimit të masave në strategjinë dhe planin e veprimit për zbatimin e të drejtave të autorit, problematikën e zbatimit të tyre, si dhe me rekomandime për përmirësimin e situatës. Takimet për monitorimin e strategjisë 2016-2020, janë zhvilluar dy herë në vit, po ashtu dhe për SKPI 2022-2025. Meqë Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Intelektuale është lider i kësaj strategjie dhe zhvillon takime për monitorimin e këtyre strategjive nga Drejtoria e të Drejtës së Autorit nuk ka informacion mbi monitorimin dhe takimet e zhvilluara, lidhur me detyrat e realizuara.

<sup>15</sup> “Pronësia Intelektuale” përfshin të drejtat në lidhje me:


- veprat letrare, artistike dhe shkencore,
- shfaqjet artistike, fonogramat dhe transmetimet,
- shpikjet në të gjitha fushat e veprimtarisë njerëzore,
- zbulimet shkencore,
- disenjot industriale,

- markat tregtare, markat e shërbimit, emrat tregtarë dhe emërtimet e origjinës, mbrojtjen kundër konkurrencës së pandershme dhe të gjitha të drejtat e tjera që rezultojnë nga aktiviteti intelektual, në fushat industriale, shkencore, letrare ose artistike.

<sup>16</sup> Raporti i rekomandimeve të WIPO-s.

E drejta e autorit në Republikën e Shqipërisë sanksionohet përveçse në Kushtetutë, ligjin organik të saj edhe në strategjitë kombëtare të pronësisë intelektuale. Megjithatë nga auditimi konstatohet se, kjo e drejtë nuk është analizuar plotësisht dhe përafruar me direktivat e BE-së, të cilat nuk orientohen në përputhje me kontekstin kombëtar, vlerësim i arritur edhe në përgjigjet zyrtare të subjekteve nën auditim.

Skema nr. 5. Skema funksionale e pronësisë intelektuale



Burimi: Përpunuar nga GA.

*Kuadri ligjor dhe rregullator për të drejtën e autorit*

*Përafrimi me direktivat e BE-së*

Mbrojtja e të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, duhet të garantojë, harmonizimin e legjislacionit me *acquis communautaire* në këtë fushë, në të njëjtin nivel me atë të vendeve të Bashkimit Evropian, për fuqizimin e masave ndëshkuese, kontrolluese dhe monitoruese, vendosjen e “filtrave” për masa më efektive për prodhuesit, përdoruesit apo shfrytëzuesit e veprave kulturore, artistike dhe shkencore, përcaktimin e detyrave dhe procedurave administrativo-ligjore për institucionet shtetërore të përfshira në këto procese.

Gjykuar në sa më sipër, gjatë periudhës objekt auditimi 2019-2022, Ministria e Kulturës dhe Drejtoria për të Drejtën e Autorit kanë bërë një përparim të pjesshëm për përafrimin me legjislacionin evropian<sup>17</sup>, por jo të plotë. Ligji për të drejtën e autorit ka përafruar plotësisht 7 direktiva të legjislacionit të BE-së për të drejtën e autorit, 4 prej tyre në mënyrë të pjesshme, si konkretisht:

-Direktivën nr. 2012/28, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropian, datë 25 tetor 2012, “Për përdorime të caktuara të lejuara të veprave pa autor”. (pika 4 e nenit 75/2 dhe të pikës 5 të nenit 157 të ligjit).

-Direktivën e Këshillit 93/83/KEE, datë 27 shtator 1993, “Mbi koordinimin e rregullave të caktuara në lidhje me të drejtën e autorit dhe të drejtave të lidhura me të drejtën e autorit të aplikueshme në transmetimet satelitore dhe ritransmetimet kablore”.

-Direktivën 2014/26/ BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 26 shkurt 2014, “Për menaxhimin kolektiv të së drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të dhe licencimi multi - territorial i të drejtave në veprat muzikore për përdorim në internet në tregun e brendshëm”.

<sup>17</sup> Raportet e Komisioni Evropian në kapitullin 7

-Direktivën 2017/1564 (BE), të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropian, datë 13 shtator 2017, “Mbi disa përdorime të lejuara të veprave të caktuara dhe fusha të tjera të mbrojtura nga e drejta e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to në përfitim të personave të cilët janë të verbër, me shikim të dëmtuar ose ndryshe me aftësi të kufizuara në leximin e materialeve të printuara” dhe amendimin e direktivës 2001/29/KE mbi harmonizimin e aspekteve të caktuara të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to në shoqërinë e informacionit”.

Në kuadër të objektivit strategjik në SKPI-në 2016-2020, për ratifikimin e marrëveshjeve në fushën e të drejtës së autorit, në planin e veprimit ka qenë Aderimi në dy traktate, Traktatin e Marakeshit për personat me dëmtime në shikim, planifikuar në vitin 2017 dhe Traktatin e Pekinit mbi veprat audiovizuale<sup>18</sup>, planifikuar në vitin 2018, rrjedhojë e të cilave janë dy prej direktivave të mësipërme. Procesi përgatitor për ratifikimin e të dy traktateve ka nisur në vitin 2021, jashtë afateve ligjore të parashikuara dhe këto nuk janë ratifikuar ende. Dy direktivat Direktivës 2012/28/BE, Direktivës 2017/1564/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropian. janë përafuar pjesërisht.

Në këto kushte nga Drejtoria e të Drejtës së Autorit është menduar që ratifikimi i tyre mund të vendoset prioritet në fillim të vitit 2024, duke rivendosur prioritet studimin e kushteve për të aderuar në këto dy traktate, pasi të qartësohen impakti financiar, të drejtat dhe detyrimet si rrjedhojë e këtij procesi. Nga auditimi konstatohet se për shkak të një mungesë analize të procesit të hartimit të politikave nga ana e Ministrisë së Kulturës, ka sjellë mos përcaktim të afateve të hartimit të tyre.

Për direktivat e pranuar dhe miratuara në parlament , nga institucionet përgjegjëse nuk janë miratuar aktet nënligjore në zbatim të tyre, konkretisht VKM-ja për kompensimin e drejtë të veprave pa autor, krijimi i databazës së DDA-së, si dhe rregullimi i mënyrës së funksionimit të Agjencive të Administrimit Kolektiv (AAK).

Draft-aktet nënligjore janë hartuar dhe tani po përfundon procesi i konsultimit me ministrinë e linjës.

Ligji për të drejtën e autorit, i ndryshuar, në pikën 1 të nenit 133 përcakton se “Agjencitë e administrimit kolektiv, si subjekt juridik kanë si objekt të veprimtarisë së tyre mbledhjen e të ardhurave për përdorimin e veprave dhe shpërndarjen e tyre tek titullarët e së drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, e cila ka marrë licencimin nga ministria përgjegjëse për të drejtat e autorit, pas propozimit nga Drejtoria e të Drejtave të Autorit.”

Ky ligj nuk është përafuar me direktivat e tjera të Bashkimit Evropian, si më poshtë vijon:

-Direktiva (BE) 2019/789 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit e datës 17 prill 2019 “Mbi vendosjen e rregullave për ushtrimin e të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të, të zbatueshme për transmetimet online të organizatave transmetuese dhe ritransmetimet e programeve televizive dhe radiofonike dhe amendimi i Direktivës së Këshillit 93/83/KE”.

-Direktiva (BE) 2019/790 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 17 prill 2019 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to në tregun e vetëm digjital dhe amendimi i Direktivave 96/9/EC dhe 2001/29/EC”.

-Kreun e II-të të Direktivës 2014/26/ BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 26 shkurt 2014, “Për menaxhimin kolektiv të së drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të dhe licencimi multi - territorial i të drejtave në veprat muzikore për përdorim në internet në tregun e brendshëm”.

#### *Mbivendosja e kompetencave dhe marrëveshjet ndërinstitucionale*

Referuar Ligjit nr. 35/2016, kompetencat mbikëqyrëse të Drejtorisë të të Drejtave të Autorit-së kanë të bëjnë me veprimtarinë organizative dhe financiare të agjencive të administrimit kolektiv, ku DDA - ja kryen verifikimin dhe kontrollin e veprimtarisë së Agjencive të Administrimit Kolektiv

<sup>18</sup> SKPI 2016-2020 fq. 21

dhe në rast të konstatimit të shkeljeve të parashikuara në ligj, i propozon ministrit përgjegjës për të drejtën e autorit pezullimin apo heqjen e licencës së AAK-së.

Krahas kësaj, ky ligj ka parashikuar rastet e tjera që përbëjnë përgjegjësi administrative, që janë pjesë e kompetencave të Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut i cili ka funksionin e mbikëqyrjes së tregut për inspektimet *ex-officio (në terren)* të ISHMT-së, inspektimet për tregtimin *on line*, procedurat e bllokimit dhe shkatërrimit të mallrave pirate dhe të falsifikuara, koordinimin ndërinstitucional dhe rolin e ISHMT, metodologjinë e llogaritjes së tarifave të masave administrative, mungesën e manualeve për procedurat e standardizuara për ISHMT në lidhje me monitorimin e respektimit të të drejtës së autorit, në tregun e brendshëm të Republikës së Shqipërisë.

-Ligji nuk është i qartë në lidhje me monitorimin e veprimtarisë së të gjitha kategorive të të drejtave të autorit nga ISHMT. Nuk janë hartuar dhe miratuar ndryshimet e nevojshme ligjore në lidhje me, procedurat e mbikëqyrjes së tregut për inspektimet *ex-officio* të ISHMT-së.

Ligji nuk referon përgjegjësinë në lidhje me monitorimin e strukturave transmetuese të prodhimeve audiovizuale. Në kushtet e reja të krijimit të një sistemi të plotë mbrojtës të së drejtës së autorit online, ligji për të drejtën e autorit, aktualisht nuk ofron asnjë formë rregullimi në lidhje me monitorimin.

Ligji i të drejtës së autorit nuk është i qartë në lidhje me theksin tek fusha e zbatimit të të drejtës së autorit. Konkretisht:

Neni 157 i Ligjit nr. 35/2016<sup>19</sup>, të ndryshuar në pikën 2 të tij ku përcaktohen detyrat e DDA, specifikon:

a) “propozon, harton dhe zbaton strategjinë dhe politikën e duhur për mbrojtjen .....”;

ç) “propozon akte ligjore lidhur me mbrojtjen, ushtrimin dhe zbatimin e së drejtës së autorit.....”.

Ndërkohë neni 178 i Ligjit nr. 35/2016, i ndryshuar, përcakton se mbikëqyrja dhe inspektimi për zbatimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura bëhet në përputhje me ligjin për inspektimin nga inspektorati që mbulon fushën e mbikëqyrjes së tregut, pranë ministrisë përgjegjëse për tregtinë.

Ligji i të drejtës së autorit aktualisht nuk përcakton dispozita në lidhje me kontrollin dhe mbikëqyrjen në fushën digjitale të të drejtës së autorit, një domosdoshmëri në kushtet e reja të zbatimit të kësaj të drejte.

Ligji i të drejtës së autorit nuk ka dispozitë autorizuese në lidhje me përgjegjësitë për kontrollin e zbatimit të ligjit nga OSHMA-të. Kjo përgjegjësi parashikohet në ligjin organik të AMA-s por është mangësi në ligjin kuadër të të drejtës së autorit.

### *Amendime ligjore*

Në lidhje me rishikimin e metodologjisë dhe mbledhjen e tarifave të shpërblimit për të drejtën e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me to, agjencitë e administrimit kolektiv së bashku me Sportelin Unik, iniciuan procedurat negociuese për një marrëveshje gjithëpërfshirëse me shoqatat e përdoruesve për tarifën e shpërblimit, përgjatë muajit prill të vitit 2022.

Sipas neni 144 të Ligjit nr. 35/2016, të ndryshuar, lidhur me këtë procedurë përcaktohet se, nëse nuk është përfunduar një marrëveshje brenda një muaji nga fillimi i negociatave, do të kërkohet vendimmarrje nga Këshilli Kombëtar i të Drejtës së Autorit, i cili ka si funksion miratimin e metodologjisë dhe masës së tarifave të shpërblimit të mbajtësve të të drejtës së autorit. Negociatat midis shoqatave të përdoruesve dhe AAK-ve, kanë filluar që më datë 03.06.2022 dhe përfunduan më datën 15 Shtator 2022, pa marrëveshje gjithëpërfshirëse.

Procedura e arritjes në një marrëveshje gjithëpërfshirëse parashikon ndërhyrjen e KKDA, nisur nga një kërkesë me shkrim nga kushdo, që vërteton një interes të ligjshëm. Aktualisht nuk ka asnjë kërkesë drejtuar KKDA për të vendosur mbi marrëveshjen gjithëpërfshirëse.

Në këto kushte, që prej vitit 2017 nuk janë rishikuar metodologjia dhe masat e shpërblimit.

<sup>19</sup> Ligji për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me to.

Grupi i auditimit, duke marrë parasysh evidencat shkresore edhe përgjigjet zyrtare të subjekteve nën auditim, vlerëson se ka mangësi ligjore, për parashikimin e afatit kohor për ndërhyrjen e Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit, në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tejzgjatura ndërmjet shoqatave të përdoruesve dhe AAK-ve.

Në nenin 146 të Ligjit nr. 35/2016, të ndryshuar, parashikohet se shpenzimet e procedurës para KKDA-së, përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për të drejtën e autorit. Kjo dispozitë autorizuese për të miratuar urdhrin në kuadrin ligjor aktual është e paqartë dhe e pa aplikueshme në praktikë sepse:

-tarifat e shërbimeve nuk përcaktohen me urdhër ministri, por duhet të jenë të përcaktuara me akte nënligjore të niveleve më të larta.

-anëtarët e KKDA marrin shpërbimin e tyre për çdo mbledhje, sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr. 418, datë 27.06.2012<sup>20</sup>, e ndryshuar.

KKDA gjatë periudhës 2019-2022 ka zhvilluar dy mbledhje të cilat janë të publikuara në faqen zyrtare të MK në kundërshtim me përcaktimet ligjore<sup>21</sup>.

Bazuar në nenin 135 të Ligjit nr. 35/2016, të ndryshuar, administrimi kolektiv i të drejtave të përmendura në lidhje me të njëjtën kategori të mbajtësve të së drejtës, i jepet nga ministria përgjegjëse për të drejtat e autorit vetëm një subjekti (AAK), i cili:

“a) ka marrë pëlqimin për kryerjen e administrimit të të drejtave nga ana e shumicës së mbajtësve të të drejtave të kësaj kategorie, të cilët i kanë dhënë kompetencat e tyre të përfaqësimit për administrimin e të drejtave të tyre;

b) ka numrin më të madh të kontratave të lidhura me agjencitë reciproke të huaja, në përputhje me kriteret profesionale të përmendura në këtë ligj”.

Sipas ligjit, këto dy kushte gjykohen si më të rëndësishëm për administrimin kolektiv. Në të vërtetë dhe pse këto janë detyrime ligjore, mund të lënë vend për monopolizim të tregut, duke penguar hyrjen në treg të agjencive të reja, pasi për një AAK të re e cila plotëson më mirë kushtet e nenit 133 të ligjit për të qenë e tillë, mund të mos plotësojë kushtet e nenit 135 të ligjit, meqë nuk kanë arritur akoma një bashkëpunim me agjencitë simotra.

Referuar pikës 6, të nenit 151 të Ligjit nr. 35/2016, të ndryshuar, llogaritja dhe shpërndarja e shpërblimeve duhet të bëhet së paku një herë në vit nga AAK-të. Kjo shpërndarje mund të realizohet më thjeshtë në rast se shpërndarja nga Sporteli Unik do të kryhej çdo 6 muaj, për shumat e mbledhura nga subjektet përdorues për këto periudha. Në lidhje me këtë mënyrë shpërndarjeje, AAK-të shprehen se shumat e mbledhura për periudha më të shkurtra janë më të pakta dhe nëse shpërndarja do të bëhej në disa periudha brenda vitit do të kishte më tepër humbje të parave për shkak të komisionit bankar. DDA vlerëson se referuar kësaj dispozite, është e mundur që shpërndarja të kryhet të paktën një herë brenda vitit financiar<sup>22</sup>.

Në vlerësim të situatës konkrete, Sporteli Unik dhe AAK-të, vazhdimisht kanë shprehur shqetësimin se shpërndarja e të ardhurave brenda vitit financiar është e pamundur për shkak se shumata totale mbledhet në fund të vitit. Një shqetësim i ngritur vazhdimisht nga AAK-të lidhet me faktin se autorizimet që jepen nga Sporteli Unik janë më të hershme se kryerja e pagesave që është më e vonshme. Për sa më sipër, AAK-të pretendojnë, se shpërndarjet brenda vitit financiar, të mbajtësit e të drejtës, nuk janë të mundura.

Direktiva 2014/26/BE<sup>23</sup> “Për administrimin kolektiv të së drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me to, dhe mbi licencimin shumë terriroresh të të drejtave për veprat muzikore përmes internetit në tregun e brendshëm”, e cila është përafëruar pjesërisht në ligjin për të drejtën e autorit, parashikon se shtetet anëtare duhet të sigurojnë që organizatat e administrimit kolektiv t'i

<sup>20</sup> VKM nr. 418, datë 27.06.2012, e ndryshuar.

<sup>21</sup> Shkronjës “a”, të pikës 4, të nenit 156, të Ligjit nr. 35/2016, numri i mbledhjeve që zhvillon KKDA-ja në një vit, si rregull, është 5 (pesë).

<sup>22</sup> Përgjigje pyetësori DDA

<sup>23</sup> nenit 13, Direktiva 2014/26/BE

shpërndajnë dhe t'i paguajnë shumat ndaj titullarëve sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 9 muaj nga mbyllja e vitit financiar në të cilin janë mbledhur të ardhurat.

Ligji për të drejtën e autorit përcakton fundin e vitit financiar si afat për shpërndarjen e të ardhurave, por aktualisht në praktikë kjo është e pamundur, duke i bërë dispozitat ligjore të pazbatueshme. Këto ndryshime ligjore duhet të përfshijnë dispozitat e direktivës 2014/26 CRM për format e tjera të administrimit kolektiv, IME<sup>24</sup> dhe është e nevojshme të parashikohen dispozita ligjore në lidhje me shpërblimin e autorëve edhe pas largimit nga AAK-të dhe afatin kohor për të shpërndarë të ardhurat tek mbajtësit e të drejtës. Përafrimi i këtyre direktivave është planifikuar në Planin Kombëtar të Integritimit Evropian – PKIE, për periudhën 2024-2026.

Si rrjedhojë, grupi i auditimit konstaton pamundësinë e shpërndarjes së shpërblimeve tek autorët nga Sporteli Unik i Administrimit të së Drejtës së Autorit dhe Agjencitë të Administrimit Kolektiv të të Drejtave të Autorit, brenda vitit financiar në kundërshtim me përcaktimet ligjore<sup>25</sup>.

*Iniciativat ligjore të ndërmarra nga Ministria e Kulturës dhe DDA-ja.*

#### *Platforma elektronike*

Me VKM nr. 350, datë 26.5.2022 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale, 2022–2025”, një ndër prioritet objektive është ngritja e platformës elektronike për të drejtën e autorit, si një element i rëndësishëm për rritjen e transparencës dhe lehtësimin në verifikimin nëpërmjet ekspozimit të bazës së të dhënave të së drejtës së autorit online. Kjo platformë lehtëson procedurat për regjistrimin e të drejtës së autorit me qëllim që autorët e veprave të kryejnë regjistrimin e veprave të tyre online. Gjithashtu, kjo platformë elektronike rrit dhe performancën e Drejtorisë së të Drejtës së Autorit, duke automatizuar dhe informatizuar proceset e punës.

Në moszbatim të afateve të parashikimeve ligjore, (nenit 9 të Ligjit nr. 37/2022 dhe VKM-së nr. 350, datë 26.5.2022 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale, 2022–2025”), DDA-ja ka në proces miratimi:

-Draft VKM-në për elementet e regjistrit të të dhënave të hapura për publikun, dokumentar dhe elektronik, sipas elementeve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për bazat e të dhënave shtetërore dhe është në proces konsultimi me ministritë e linjës dhe institucionet e tjera të përfshira në këtë proces<sup>26</sup>.

-Draft udhëzimin për mënyrën e organizimit, funksionimit dhe veprimtaria e sportelit unik miratohen, në zbatim të pikës 7 të nenit 138 të Ligjit nr. 35/2016, të ndryshuar. (brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e Ligjit nr. 37/2022 dt. 14.04.2022)

Për periudhën objekt auditimi nga Ministria e Kulturës dhe DDA-ja, nuk janë hartuar:

- VKM “Për krijimin e bazës së të dhënave dhe elementët e regjistrit për të drejtën e autorit” në zbatim të pikës 5 të nenit 157 të Ligjit nr. 35/2016, të ndryshuar.
- VKM “Për kompensimin e veprave pa autor”, në zbatim të pikës 4 të nenit 75/2 të Ligjit nr. 35/2016, të ndryshuar.
- VKM “Për procedurat dhe mënyrën e shpërblimit të drejtë për huadhënie publike”, në zbatim të pikës 8 të nenit 32 të Ligjit nr. 35/2016, të ndryshuar.

#### *Ndërgjegjësimi*

Objektiv prioritar është edhe rritja e ndërgjegjësimit mbi të drejtat e autorit dhe të drejtat e lidhura përmes përdoruesve të veprave të mbrojtura me të drejtë autori, ose të drejtat e lidhura, mbajtësit e së drejtës, përfaqësuesit e tyre dhe komunitetit në përgjithësi. Ndërgjegjësimi i shoqërisë shqiptare vijon të mbetet në vëmendjen e Ministrisë së Kulturës dhe të DDA-së, me qëllim informimin dhe edukimin e gjeneratave që rriten.

<sup>24</sup> IME (Agjencia Ndërkombëtare e Pavarur e Administrimit)

<sup>25</sup> Pika 6, nenit 151 të Ligjit nr. 35/2016, të ndryshuar,

<sup>26</sup> Përgjigje pyetësores të DDA-së.

Për shumë njerëz, lidhja që ekziston midis pronësisë intelektuale dhe krijimtarisë nuk është aspak e qartë. Fjala krijimtari në vetvete nënkupton një botë artistësh, krijuesish muzikore apo të çdo lloj zhanri tjetër artistik.

Respektimi i produktit të mendjes së tjetrit, përdorimi i drejtë i tij dhe jo në mënyrë pirate, por në bazë të ligjeve të cilat veprojnë në një vend të caktuar, është një tregues i qartë i nivelit të civilizimit të një shoqërie.

Shumë shtete të Bashkimit Evropian kanë një platformë ku shpjegohet rëndësia jetësore e së drejtës së autorit në ekonominë e një shteti.

Në zbatim të pikës gj) të nenit 157 të Ligjit nr. 35/2016, të ndryshuar, DDA-ja “përgatit, promovon, shpërndan materiale informuese, organizon fushata të ndërgjegjësimit të institucioneve, grupeve të interesit dhe publikut, nëpërmjet medias elektronike dhe asaj të shkruar, .....lidhur me rëndësinë dhe aspektet politike, ligjore dhe praktike të mbrojtjes, ushtrimit dhe zbatimit të së drejtës së autorit.....”.

Gjatë periudhës 2019-2022, DDA-ja ka zhvilluar fushata ndërgjegjësuese, por vetëm në vitin 2021 ka hartuar një plan pune në të cilin përcaktohen aktivitetet dhe veprimtaritë e ndryshme të cilat kanë për qëllim edukimin e brezave dhe të shoqërisë në tërësi, mbi rëndësinë e së drejtës së autorit. Gjatë intervistave të zhvilluara dhe përgjigjet e pyetësorëve, hartimi i platformave të tilla dhe procesi i ndërgjegjësimit, i cili realizohet në vazhdimësi, kërkojnë burime financiare dhe një vëmendje më të shtuar nga eprorët e institucioneve përgjegjëse.

### **Gjetje nga auditimi:**

1. Gjatë periudhës 2020-2022 nuk ka pasur strategji kombëtare, për të drejtën e autorit. Statusi që i jepet Drejtorisë së të Drejtës së Autorit nga Strategjia e Pronësisë Intelektuale, nuk është në raport me përcaktimet e bëra nga ligji, mbi rolin dhe përgjegjësitë e kësaj drejtorie, sepse e trajton këtë drejtori si një institucion dytësor për nga rëndësia.  
-DDA-ja nuk harton një strategji të vetën, të dedikuar për mbrojtjen e të drejtës së autorit dhe garantimi i kësaj të drejte nuk parashikohet as në Strategjinë e Ministrisë së Kulturës, duke lënë jashtë fokusit të saj, rolin dhe përgjegjësinë e saj.  
Propozimi për bashkimin e Drejtorisë së të Drejtës së Autorit me Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Intelektuale, nuk lidhet me objektin e aktivitetit të DDA-së, për faktin se veprimtaria funksionale e kësaj drejtorie, është e drejta e autorit
2. Kuadri rregullator për të drejtën e autorit<sup>27</sup>, nuk është përafuar me direktivat e BE-së<sup>28</sup>:  
-Ministria e Kulturës, nuk ka propozuar hartimin e marrëveshjeve në fushën e të drejtës së autorit lidhur me Aderimin në dy traktate, Traktatin e Marakeshit “Për personat me dëmtime në shikim”, planifikuar për vitin 2017 dhe Traktatin e Pekinit “Mbi veprat audiovizuale”<sup>29</sup>, planifikuar për vitin 2018.  
-Ka përafuar pjesërisht 2 direktivat të BE-së lidhur me, koordinimin e rregullave të caktuara në lidhje me të drejtën e autorit dhe të drejtave të lidhura me të drejtën e autorit të aplikueshme në transmetimet satelitore dhe ritransmetimet kablore dhe për menaxhimin kolektiv të së drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të dhe licencimi multi -territorial i të drejtave në veprat muzikore për përdorim në internet në tregun e brendshëm.
3. Legjislacioni aktual për të drejtën e autorit krijon kushte për mbivendosje kompetencash, lidhur me monitorimin/ inspektimin dhe zbatimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura me to sepse nga institucionet përgjegjëse nuk janë propozuar ndryshimet e nevojshme ligjore mbi procedurat e mbikëqyrjes së tregut për inspektimet *ex-officio (në terren)*, inspektimet për tregtimin *on line*, procedurat e bllokimit dhe shkatërrimit të mallrave pirate

<sup>27</sup> Ligji nr. 35/2016, “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”

<sup>28</sup> Direktivën (BE) 2019/789 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 17 prill 2019 dhe Direktivën (BE) 2019/790 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 17 prill 2019.

<sup>29</sup> SKPI 2016-2020 fq. 21

dhe të falsifikuara, koordinimin ndërinstytucional duke rinovuar marrëveshjet e bashkëpunimit, ku të përcaktohen fushat e përgjegjësisë dhe të kompetencave përkatëse.

4. Është konstatuar se, që nga viti 2017, nuk ka një marrëveshje gjithëpërfshirëse të përditësuar, midis shoqatave të përdoruesve dhe agjencive të administrimit kolektiv të të drejtave të autorit. Procesi i negociimit për arritjen e saj ka dështuar, dhe nuk ka asnjë kërkesë nga aktorët e legjitimuar, pranë Këshillit Kombëtar për të Drejtën Autorit, për rishikimin e metodologjisë dhe masës së shpërblimit të tarifave për mbajtësit e të drejtave. Kuadri ligjor aktual, nuk ofron asnjë mekanizëm për zgjidhjen e këtij ngërçi.
5. Neni 146 i Ligjit nr. 35/2016, i ndryshuar, është në kundërshtim me aktet ligjore, sepse:
  - tarifave të shërbimeve nuk përcaktohen me urdhër ministri, por me akte nënligjore të niveleve më të larta;
  - sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr. 418, datë 27.06.2012, i ndryshuar, anëtarët e KKDA marrin shpërblim për çdo mbledhje. KKDA gjatë periudhës 2019-2022 ka zhvilluar vetëm dy mbledhje, në moszbatim të detyrimit ligjor.
6. Kriteret e vendosura në pikën 1 të nenit 135 të ligjit krijojnë kushte për monopolizim të tregut, duke u bërë pengesë për hyrjen në treg të agjencive të reja. Një shoqatë përfaqësuese autorësh e cila plotëson më mirë kushtet e nenit 133 të ligjit për të qenë e licencuar si agjenci administrimi kolektiv, mund të mos plotësojë kushtet e nenit 135 të ligjit, meqë nuk kanë arritur akoma një bashkëpunim me agjencitë simotra.
7. Referuar pikës 6, të nenit 151 të Ligjit nr. 35/2016, i ndryshuar, lidhur me llogaritjen dhe shpërndarjen e shpërblimeve, vlerësohet se ka boshllëk ligjor, pasi nuk përcaktohet afati kohor i shpërndarjes. Llogaritja dhe shpërndarja e shpërblimeve së paku një herë në vit nga AAK-të ka sjellë problematika lidhur me këtë proces.
8. Ministria e Kulturës dhe Drejtoria për të Drejtën e Autorit nuk kanë miratuar/hartuar aktet nënligjore për të drejtat e autorit, brenda afateve ligjore të përcaktuara. Në mungesë të tyre, aktiviteti i drejtorisë përgjegjëse është jo efektiv.
9. Gjatë periudhës 2019-2022, DDA-ja ka hartuar vetëm një plan pune në të cilin përcaktohen aktivitetet dhe veprimtaritë e ndryshme të cilat kanë për qëllim edukimin e brezave dhe të shoqërisë në tërësi, mbi rëndësinë e të drejtës së autorit. Dhe pse, në SKPI-të janë parashikuar fushatat ndërgjegjësuese, kjo është e pamundur të realizohet, për shkak të mungesës së fondeve.

#### **Konkluzione:**

1. Mungesa e një strategjie të dedikuar si dhe trajtimi i Drejtorisë për të Drejtën e Autorit, si institucion dytësor për nga rëndësia, në kundërshtim me statusin që ligji i njeh, ka bërë që objektivat e strategjisë kombëtare të pronësisë intelektuale të jenë pjesërisht të realizuara.
2. Përafrimi i plotë me direktivat e BE-së si dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit shmangin mbivendosjen e kompetencave dhe problematikave midis institucioneve në fushën e monitorimit/ inspektimit dhe zbatimit të së drejtë së autorit.
3. Dispozitat ligjore lidhur me, metodologjinë dhe masën e tarifave, shpërblimin e Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit, kriteret e licencimit, mospërcaktimin e afateve kohore të shpërndarjes së shpërblimeve, prodhojnë efekte negative mbi proceset e administrimit kolektiv të së drejtës së autorit.

4. Miratimi i akteve nënligjore dhe ngritja e platformës elektronike për të drejtën e autorit, si një element i rëndësishëm për rritjen e transparencës nëpërmjet ekspozimit të bazës së të dhënave të së drejtës së autorit online, sjell jo vetëm lehtësimin e procedurave, por rrit dhe performancën e Drejtorisë së të Drejtës së Autorit.
5. Përhapja e informacionit me synim rritjen e ndërgjegjësimit mbi të drejtën e autorit, janë një garanci për zhvillimin ekonomik-social të vendit.

#### **Rekomandime:**

1. Ministria e Kulturës si institucion përgjegjës në fushën e të drejtës së autorit, të krijojë një grup pune për rishikimin e dokumenteve politike si dhe vlerësimin e mundësisë së hartimit të një strategjie të dedikuar për të drejtën e autorit, sipas ligjit që e sanksionon këtë të drejtë.  
*Menjëherë*
2. Ministria e Kulturës të propozojë, rishikimin e akteve nënligjore lidhur me mënyrën e funksionimit, të organizimit dhe të shpërblimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit, si dhe krijimin e një mekanizmi për ndërhyrjen e tij në procesin e rishikimit të metodologjisë dhe masës së tarifave të shpërblimit.  
*Menjëherë*
3. Ministria e Kulturës në bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut dhe Autoritetin e Mediave Audiovizive, të marrin masat për ndryshimet ligjore në shmangien e mbivendosjes së kompetencave sipas fushave të përgjegjësive, si dhe të rishikojnë/nënshkruajnë marrëveshjet e bashkëpunimit, lidhur me garantimin e mbrojtjes të së drejtës së autorit.  
*Menjëherë*
4. Ministria e Kulturës në bashkëpunim me grupet e interesit të ndërmarrë iniciativa për rritjen e ndërgjegjësimit të shoqërisë lidhur me garantimin e mbrojtjes së të drejtës së autorëve të veprave dhe rëndësinë e kësaj të drejte në ekonominë e vendit.  
*Menjëherë*
5. Ministria e Kulturës të marrë masat për miratimin e akteve nënligjore në përputhje me direktivat e Bashkimit Evropian për:
  - rishikimin e llogaritjes dhe shpërndarjes së shpërblimeve duke përcaktuar një afat të përshtatshëm për shpërndarjen e tyre;
  - krijimin e bazës së të dhënave dhe elementët e regjistrit për të drejtën e autorit, për kompensimin e veprave pa autor, si dhe udhëzimin për mënyrën e organizimit, funksionimit dhe veprimtarinë e sportelit unik;
  - rishikimin e kriterëve të përfaqësimit për administrimin e të drejtave për të shmangur monopolizimin e tregut.

*Brenda gjashtëmuajorit të parë të vitit 2024*

#### **4.2 A ka qenë efektiv procesi i administrimit të së drejtës së autorit?**

##### **4.2.1 Si ka funksionuar mekanizmi i ngritur për administrimin kolektiv të së drejtës së autorit?**

###### *Historik mbi administrimin kolektiv të së drejtës së autorit*

Administrimi i të drejtës së autorit, në vendin tonë, sikurse në të gjitha vendet e tjera të Evropës, realizohet nga organizata jo fitimprurëse, të cilat i nënshtrohen procedurave të përzgjedhjes dhe licencimit për një periudhë trevjeçare, si agjenci të administrimit kolektiv, nga Ministria e Kulturës,

institucion ky, përgjegjës për garantimin dhe mbrojtjen e kësaj të drejte, pas propozimit të bërë nga Drejtoria për të Drejtën e Autorit.

Gjatë periudhës objekt auditimi, Ministria e Kulturës në procedurat e licencimit, ka autorizuar katër shoqata mbajtësish të të drejtave të autorit, që të operojnë si agjenci të administrimit kolektiv (AAK) të të drejtave. Këto agjenci, kanë si objekt të veprimtarisë së tyre, mbledhjen e të ardhurave për përdorimin e veprave dhe shpërndarjen e tyre tek titullarët e së drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të.

Ligji për të drejtën e autorit parashikon që sistemi i administrimit kolektiv të jetë i bazuar në parimin e gjithëpërfshirjes, si për mbajtësit e të drejtës së autorit, ashtu edhe për përdoruesit e këtyre veprave.

Sistemi Shqiptar i administrimit kolektiv përcakton, që vetëm një agjenci mund të përfaqësojë një kategori të drejtash. Ky kriter administrimi kolektiv, synon të fokusojë përfaqësimin e mbajtësve të të drejtave dhe të rrisë përpjekjet për të përmirësuar procesin.

Administrimi kolektiv i të drejtave i cili realizohet nga subjekte juridike private, nga ana tjetër licencohet dhe monitorohet nga Ministria e Kulturës, nëpërmjet Drejtorisë për të Drejtën e Autorit. Prandaj garantimi dhe mbrojtja e të drejtës së autorit, varet shumë nga ndërveprimi dhe koordinimi i punës së agjencive të administrimit kolektiv dhe kësaj drejtorie. Pa një administrim korrekt të së drejtës së autorit nga AAK – të, kjo e drejtë nuk garantohet. Kjo është arsyeja që e shtyu Grupin e Auditimit të trajtonte këtë administrim në një seksion të posaçëm.

*Sportelit Unik për Administrimin e të Drejtës së Autorit - SUADA.*

Me Udhëzimin nr. 663 datë 10.10.2017 “Për mënyrën e funksionimit dhe të organizimit të Sportelit Unik për administrimin e të drejtës së autorit – SUADA në administrimin kolektiv”, u krijua ky Sportel, i cili ka për objekt veprimtarie kryerjen e shërbimeve për funksionin e mbledhjes së tarifave të shpërblimit, në territorin e Republikës së Shqipërisë, për të gjitha kategoritë e mbajtësve të të drejtave në administrimin kolektiv.

Të gjitha AAK-të e licencuara janë anëtare në Këshillin Mbikëqyrës të “Sportelit Unik për Administrimin e të Drejtës së Autorit”<sup>30</sup> dhe SUADA përfaqëson një partneritet të të gjitha AAK-ve<sup>31</sup>.

Me Vendimin nr. 4, të datës 10.10.2017 të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit, funksioni i mbledhjes së tarifave i’u transferua agjencisë së administrimit kolektiv “AMP”, për drejtimin e sportelit unik dhe me Vendimin nr. 9, të datës 11.05.2020 të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit<sup>32</sup>, drejtimi i këtij sporteli u kaloi të katër AAK-ve të licencuara bashkërisht.

Autorizimet e përdorimit të të drejtës së autorit janë të hapura për të gjithë përdorimet e të drejtës, ndryshe të quajtura “autorizime të hapura”. Shpërblimet e mbledhura prezumohet që janë mbledhur për të gjithë krijuesit në të njëjtën kohë. Ky parim duhet të garantojë gjithëpërfshirje dhe përfitim nga tregu i të drejtës së autorit, për të gjithë mbajtësit e të drejtës, përfshirë dhe ata të cilët nuk mund të informohen dhe nuk kanë mundësi administrimi të të drejtave të tyre.

Kjo qasje synon të jetë një mënyrë efektive për të gjithë përdoruesit, të cilët me pajisjen me autorizim angazhohen të shlyejnë të gjithë detyrimet ndaj të drejtës së autorit.

Sistemi Shqiptar i administrimit kolektiv propozon prezumimin, si koncept i cili trajton në mënyrë të barabartë anëtarët dhe jo anëtarët e agjencisë së administrimit kolektiv, meqë autorët gëzojnë të drejtën e autorit mbi veprat e tyre, sipas parashikimeve të ligjit për të drejtën e autorit, për faktin e vetëm të realizimit të krijimit. Për ekzistencën dhe zbatimin e së drejtës së autorit nuk kërkohet asnjë regjistrim i veprës ose formalitete të tjera<sup>33</sup>.

<sup>30</sup> Udhëzimi Nr. 663 datë 10.10.2017 “Për mënyrën e funksionimit dhe të organizimit të Sportelit Unik për administrimin e të drejtës së autorit – SUADA në administrimin kolektiv”, kreu II, paragrafi 2.

<sup>31</sup> Udhëzimi Nr. 663 datë 10.10.2017 “Për mënyrën e funksionimit dhe të organizimit të Sportelit Unik për administrimin e të drejtës së autorit – SUADA në administrimin kolektiv”, kreu II, paragrafi 6.

<sup>32</sup> Vendimi nr. 9, i datës 11.05.2020 i Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit “Për transferimin e funksionit të mbledhjes së tarifave për të gjitha kategoritë të mbajtësve të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to në administrimin kolektiv dhe drejtimin e sportelit unik të administrimit të së drejtës së autorit – SUADA”

<sup>33</sup> Ligji Nr. 35, datë 31.03.2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar, neni 17.

### *Licencat*

Aktiviteti i AAK – ve u autorizua nga Ministria e Kulturës, pas procesit të licencimit të shoqatave të mbajtësve të të drejtave, në vitin 2018, me urdhrat si më poshtë:

- Urdhri nr. 432, datë 6.7.2018 “Për ripërtëritjen e licencës me kusht agjencisë Albautor në administrimin kolektiv të të drejtave të autorëve të veprave artistike dhe letrare”;
- Urdhri nr. 433 datë 6.7.2018 “Për ripërtëritjen e licencës agjencisë FMAA në administrimin kolektiv të të drejtave të autorëve në fushën e kinematografisë dhe të veprave të tjera audiovizuale”;
- Urdhri nr. 434 datë 6.7.2018 “Për ripërtëritjen e licencës me kusht agjencisë AKDIE në administrimin kolektiv të të drejtave të artistëve interpretues;
- Urdhri nr. 437 datë 6.7.2018 “Për licencimin e shoqatës Gramm-A, si agjenci e administrimit kolektiv në fushën e mbajtësve të të drejtave të prodhuesve të fonogrameve dhe videogrameve”.

Në bazë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, agjencisë Gramma, i’u shfuqizua licenca si agjenci e administrimit kolektiv në fushën e prodhuesve të fonogramit/vidiogramit. Për të mbuluar këtë fushë, në bazë të Urdhrit nr. 545, datë 30.8.2021 “Për licencimin e shoqërisë Agjencia e Administrimit Kolektiv “F. C. P.” në administrimin kolektiv në fushën e të drejtave të prodhuesve të fonogramit”, është licencuar agjencia “F. C. P.”.

Edhe kjo procedurë për licencimin e AAK-së F.ka qenë pjesë e një konflikti gjyqësor, por që është fituar në shkallë të parë nga Ministria e Kulturës, ku gjykata ka vendosur rrëzimin e pretendimit për shfuqizimin e licencës.

### *Kushti i licencës së A.*

AAK – ja A. ka zhvilluar aktivitetin e saj, gjatë periudhës 2019-2021 pas ripërtëritjes së licencës në vitin 2018. Lidhur me Urdhrin nr. 432, datë 6.7.2018 “Për ripërtëritjen e licencës me kusht agjencisë “A.” në administrimin kolektiv të të drejtave të autorëve të veprave artistike dhe letrare”, konstatohet se në përmbajtjen e këtij dokumenti është përcaktuar se “ripërtërihet licenca, me kushtin që të depozitohet në fondin special, në zbatim të nenit 151/9 të ligjit 35/2016, shuma prej 6,7 milion lekë, e konstatuar nga Drejtoria e Buxhetit dhe menaxhimit të Financës, e cila nuk i është shpërndarë titullarëve të të drejtave.”<sup>34</sup>

Meqenëse afati i shlyerjes së këtij detyrimi parashikohej të ishte 6 muaj, pra ky afat përfundonte më 06.01.2019 (pra brenda periudhës në fokus auditimi), GA u ndal për të verifikuar zbatimin e këtij detyrimi. Ndërkohë, A. e ka zhvilluar me këtë licencë me kusht, aktivitetin deri në vitin 2021, Licenca më pas është ripërtërirë sërish nga MK.

Pyetjes së ngritur nga GA, lidhur me këtë problem, DDA - ja i dha këtë përgjigje: “Sqaroj se referuar Urdhrit nr. 432, datë 06.07.2018 për ripërtëritjen e licencës me kusht për agjencinë A., nuk figuron dokument në Drejtorinë për të Drejtën e Autorit për plotësimin e kushtit të pikës 1 të urdhrin.

Si e tillë, nuk është depozituar në fondin special në zbatim të nenit 151/9 të Ligjit 35/2016, i ndryshuar, shuma prej 6.7 milion leke e konstatuar nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit të Financës, e cila nuk i është shpërndarë titullarëve të të drejtave”<sup>35</sup>.

### *Fondi Special*

Gjatë aktivitetit të tij auditues GA konstatoi një problem lidhur me Fondin Special.

Sikurse parashikohet në ligj, tarifat e shpërblimeve të mbledhura nga përdoruesit, të cilat në përfundim të vitit financiar nuk shpërndahen nga AAK-ja, depozitohen në një fond special për llogari të ministrisë përgjegjëse për të drejtat e autorit, në dispozicion të titullarëve të të drejtave të autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhura me to për një periudhë 3-vjeçare<sup>36</sup>. Mungesa e çeljes së

<sup>34</sup> Paragrafi 1 i Urdhrit nr. 432, datë 6.7.2018 “Për ripërtëritjen e licencës me kusht agjencisë ”Albautor” në administrimin kolektiv të të drejtave të autorëve të veprave artistike dhe letrare”.

<sup>35</sup> Përgjigje e dhënë nga DDA me e-mail, më datë 11.10.2023.

<sup>36</sup> Ligji Nr. 35, datë 31.03.2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar, neni 151, paragrafi 9.

kësaj llogarie të dedikuar për Fondin Special, pamundëson ekzekutimin e detyrimit të mësipërm nga AAK – të.

Në vitin 2021 MK autorizoi aktivitetin e AAK – ve, nëpërmjet urdhrave si më poshtë:

- Urdhri nr. 544, datë 30.8.2021 “Për ripërtëritjen e licencës së shoqërisë “FMAA” në administrimin kolektiv të të drejtave të autorëve në fushën e kinematografisë dhe të veprave të tjera audiovizuale”;
- Urdhri nr. 545, datë 30.8.2021 “Për licencimin e shoqërisë “Agjencia e Administrimit Kolektiv “F. C. P.” në administrimin kolektiv në fushën e të drejtave të prodhuesve të fonogramit”;
- Urdhri nr. 546, datë 30.8.2021 “Për ripërtëritjen e licencës së shoqërisë “A.K.D.I.E” në administrimin kolektiv të të drejtave të artistëve interpretues dhe ekzekutues”;
- Urdhri nr. 547, datë 30.8.2021 “Për ripërtëritjen e licencës së shoqërisë “A.” në administrimin kolektiv në fushën e të drejtave të autorit, për veprat muzikore me apo pa tekst”.

Aktualisht në fushën e të drejtës së autorit, operojnë AAK-të, “A.”, “FMAA”, “AKDIE” dhe “F.C. P.”.


Agjencia e Administrimit Kolektiv, A., licencuar në fushën e kompozimeve muzikore me ose pa tekst, gjatë vitit 2022 ka deklaruar 271 kontrata me autorë shqiptarë dhe 83 marrëveshje reciproke me agjenci të huaja simotra.

Agjencia “AKDIE”, licencuar në administrimin kolektiv të të drejtave të artistëve interpretues dhe ekzekutues, gjatë vitit 2022 ka deklaruar 459 kontrata me autorë shqiptarë dhe 18 marrëveshje reciproke me agjenci të huaja simotra.

Agjencia “F.”, licencuar në administrimin kolektiv të të drejtave të prodhuesve të fonogrameve, ku përfshihen personat fizikë ose juridikë që kryejnë fiksimin e tingujve të një interpretimi ose tingujve të tjerë, gjatë vitit 2022 ka deklaruar 47 kontrata me autorë shqiptarë dhe 1 marrëveshje reciproke me agjenci të huaj simotra.

Agjencia “F.M.A.A”, licencuar në administrimin kolektiv të të drejtave në fushën e kinematografisë dhe veprave të tjera audiovizuale, gjatë vitit 2022 ka deklaruar 146 kontrata me autorë shqiptarë.

Skema nr. 6. Marrëdhënia hirarkike dhe funksionale



Burimi: Punuar nga Grupi i Auditimit

Duke qenë se AAK - të dhe SUADA janë OJF dhe aktiviteti i tyre rregullohet nga statutet përkatëse, të depozituar në Gjykatën e Tiranës, këto subjekte juridike u audituan në mënyrë të tërthortë. Gjatë procesit auditues, gjithsesi këtyre OJF-ve, nëpërmjet DDA-së, i'u përcollën pyetësorë nga Grupi i Auditimit, me synim vjeljen e informacionit, rreth aktivitetit të tyre.

Metodologjia për masën e tarifave të shpërblimit.

Këshilli Kombëtar për të Drejtën e Autorit me Vendimin Nr. 3, datë 04.08.2017, “Për miratimin e metodologjisë dhe masës së tarifave të shpërblimit të veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit në sistemin e administrimit kolektiv”, përcaktoi kornizën rregullatore të procesit të shpërndarjes së shpërblimeve.

Në procedurën e miratimit të tarifave të shpërblimit për përdorimin e të drejtave të autorit përcaktohet vlera/tarifa dhe metodologjia për përcaktimin e tyre, për t’u paguar nga çdo përdorues kundrejt AAK-së, për përdorimin e veprës/ve të autorit që ato administrojnë. Tarifa vendoset me anë të një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse e lidhur ndërmjet AAK-së dhe përfaqësuesve të shoqatës së përdoruesve ose, nëse kjo nuk është e mundur, me vendim të KKDA-së. Deri në hyrjen në fuqi të tarifave të reja, gjejnë zbatim tarifave të miratuara më parë.<sup>37</sup>

Ligji dhe aktet e tjera rregullatore, nuk përcaktojnë afate sa i përket, rishikimit të kësaj metodologjie. Nga ana e saj DDA, në përgjigjen e datës 06.07.2023, dhënë pyetësorit të përgatitur nga GA, shprehet se: “Tarifat e shpërblimit të të drejtave të autorit janë miratuar në vitin 2017 dhe sot ndodhemi në kushte tërësisht të ndryshme financiare, numër të shtuar përdoruesish të së drejtës dhe ka një kulturë tjetër të përdorimit të këtyre të drejtave. Duke mbajtur në vëmendje gjithashtu që janë shtuar dhe kategoritë e përdoruesve të të drejtave të paparashikuara më parë në metodologjinë ekzistuese, është e nevojshme që këto tarifa dhe metodologjia që i shoqëron të rishikohen. DDA ka asistuar të gjithë procesin e miratimit të metodologjisë dhe tarifave të reja të të drejtës së autorit. Megjithatë në mungesë të një marrëveshjeje mes palëve, DDA në cilësinë Sekretariatit Teknik të KKDA mund të vendosë këtë të fundit në lëvizje vetëm nëse ka interes nga palët e përfshira në këtë proces. Deri tani nuk ka pasur një kërkesë të tillë të depozituar edhe pse në mënyrë të vazhdueshme njoftojmë palët për rëndësinë e saj”. Gjatë auditimit u konstatua se në lidhje me rishikimin e metodologjisë dhe mbledhjes së tarifave të shpërblimit për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to, se agjencitë e administrimit kolektiv së bashku me Sportelin Unik, iniciuan procedurat negociuese për një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse me shoqatat e përdoruesve për tarifave të shpërblimit, përgjatë periudhës 03.06.2022 – 29.08.2022 dhe u realizuan nëntë takime midis tyre. Procesi i negociimit u mbyll pa një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse ndërmjet palëve.

Në legjislacionin në fuqi parashikohet se, tarifave vendosen me anë të një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse e lidhur ndërmjet AAK-së dhe përfaqësuesve të shoqatës së përdoruesve ose, nëse kjo nuk është e mundur, me vendim të KKDA-së. Deri në hyrjen në fuqi të tarifave të reja, gjejnë zbatim tarifave të miratuara më parë. Kur nuk ka tarifa të miratuara më parë, për aq kohë sa tarifave të reja nuk janë miratuar, përdoruesit i paguajnë agjencisë së administrimit kolektiv një tarifë provizore/të përkohshme, të barabartë me 60 për qind të vlerës së projekt tarifave të paraqitura<sup>38</sup>.

Po ashtu, në ligj përcaktohet se, një AAK ose një shoqatë përfaqësuese e përdoruesve, kur ata nuk e kanë përfunduar një marrëveshjeje brenda një muaji nga fillimi i negociatave mes tyre, i kërkon KKDA-së për të caktuar/vendosur një tarifë të përshtatshme ose për të vendosur për çdo çështje tjetër në lidhje me marrëveshjen gjithëpërfshirëse. Kushdo, që vërteton një interes të ligjshëm, mund të kërkojë që KKDA-ja të shprehet..<sup>39</sup>

Është fakt se KKDA-së ligji nuk i ofron mundësi për të ndërmarrë nisma të njëanëshme, pa kërkesën e një subjekti të legjitimuar, kurdo që procesi i negociimit të metodologjisë dhe masës së tarifave të shpërblimit ngecën.

Por nga ana tjetër DDA - së ligji i njej të drejtën që të konsultohet dhe të bashkëpunojë me përfaqësuesit e mbajtësve të interesuar të të drejtave dhe përdoruesve<sup>40</sup>, sikurse dhe të përgatisë, organizojë fushata të ndërgjegjësimit të grupeve të interesit<sup>41</sup>. Dështimi i procesit të negociimit për rishikimin e metodologjisë dhe masës së tarifave të shpërblimit, evidenton pamjaftueshmërinë e punës së bërë nga DDA në këtë proces.

<sup>37</sup> Ligji Nr. 35, datë 31.03.2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar, neni 142, paragrafi 1 dhe 2.

<sup>38</sup> Ligji Nr. 35, datë 31.03.2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar, neni 142, paragrafi 1 dhe 2.

<sup>39</sup> Ligji Nr. 35, datë 31.03.2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar, neni 144, paragrafi 1 dhe 2.

<sup>40</sup> Ligji Nr. 35, datë 31.03.2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar, neni 157, paragrafi 2, germa b.

<sup>41</sup> Ligji Nr. 35, datë 31.03.2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar, neni 157, paragrafi 2, germa gj.

Miratimi i metodologjisë dhe masës së tarifave të shpërblimit të veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit në sistemin e administrimit kolektiv është një nga nën objektivat e VKM-së Nr. 350, datë 26.5.2022 “Për miratimin e strategjisë kombëtare për pronësinë intelektuale, 2022–2025”.

*Përmbledhëse e veprimtarive financiare të AAK-ve*

Referuar aktivitetit të realizuar nga agjencitë e administrimit kolektiv gjatë periudhës 2019-2022, aspektet me domethënëse të këtij aktiviteti përfaqësohen në formë tabelle nga përmbledhësja e mëposhtme e të dhënave, Tabela nr. 4, përkatësisht për AAK – të: FMMA, A., AKDIE dhe F..

Tabela nr. 4. Përmbledhëse e veprimtarive financiare të AAK-ve, për periudhën 2019 –2022.

AAK	Emërtimi	Viti			
		2019	2020	2021	2022
FMMA	Të arkëtuara	13,515,937.40	16,352,692.79	10,051,564.49	10,962,894.00
	Shpenzime administrative	6,276,223.73	8,270,727.73	6,295,451.59	3,910,996.00
	Shpërndarje	3,477,579.29	5,476,062.12	2,999,981.41	3,848,545.00
	Përqindje faktike të shpërndarjeve	<b>180%</b>	<b>151%</b>	<b>210%</b>	<b>102%</b>
	Gjendja në llogari në fund të vitit financiar (lekë)	4,114,067.79	1,368,656.99	671,356.99	4,480,956.29
	Gjendja në llogari në fund të vitit financiar (valutë e huaj)	----	114,808.75 lekë	61,011.5 lekë	511.46 euro
	Numri i anëtarëve që kanë përfituar shpërblime	Anëtarë- <b>174</b> Shpërndarë- <b>78</b>	Anëtarë- <b>168</b> Shpërndarë- <b>131</b>	Anëtarë- <b>174</b> Shpërndarë- <b>72</b>	Anëtarë- <b>146</b> Shpërndarë- <b>102</b>
Albautor	Të arkëtuara	29,139,105.35	21,397,362.94	32,622,228.00	8,925,230.00
	Të arkëtuara nga agjencitë simotra	---	---	---	10,558,734.16
	Shpenzime administrative	8,687,785.20	7,780,350.37	7,311,259.52	5,950,794.00
	Shpërndarje	9,436,621.18	6,669,368.14	2,750,848.03	15,880,985.66
	Përqindje faktike të shpërndarjeve	<b>92%</b>	<b>117%</b>	<b>266%</b>	<b>37%</b>
	Gjendja në llogari në fund të vitit financiar (lekë)	6,896,588.12	103,283.85	17,548,875.82	5,879,686.32
	Gjendja në llogari në fund të vitit financiar (valutë e huaj)	6,227,799.56 lekë	3,715,915.67 lekë	4,622,380.92 lekë	125,815.74 euro
	Numri i anëtarëve që kanë përfituar shpërblime	Anëtarë- <b>190</b> Shpërndarje- <b>134</b>	Anëtarë- <b>219</b> Shpërndarje- <b>153</b>	Anëtarë- <b>254</b> Shpërndarje- <b>142</b>	Anëtarë- <b>271</b> Shpërndarje- <b>183</b>
	Të arkëtuara	15,303,964.63	3,784,569.19	24,794,105.59	15,015,614.00
	Shpenzime administrative	6,271,128.13	3,554,700.42	11,076,431.85	3,475,859.00
	Shpërndarje	5,621,191.29	43,345.71	10,083,164.46	16,043,590.60
	Përqindje faktike të shpërndarjeve	<b>105%</b>	<b>8201%</b>	<b>110%</b>	<b>22%</b>

<b>AKDIE</b>	<b>Gjendja në llogari në fund të vitit financiar (lekë)</b>	2,111,645.21	921.06	7,698,106.54	4,205,023.57
	<b>Gjendja në llogari në fund të vitit financiar (valutë e huaj)</b>	---	6,756.88 lekë	12,942.74 lekë	52.35 euro 10.69 GBP
	<b>Numri i anëtarëve që kanë përfituar shpërblime</b>	Anëtarë- <b>413</b> Shpërndarje- <b>372</b>	Anëtarë- <b>426</b> Shpërndarje- <b>25</b>	Anëtarë- <b>438</b> Shpërndarje- <b>346</b>	Anëtarë- <b>459</b> Shpërndarje- <b>356</b>
<b>FABER</b>	<b>Të arkëtuara</b>	---	---	---	12,791,762.00
	<b>Shpenzime administrative</b>	---	---	---	1,872,297.75
	<b>Shpërndarje</b>	---	---	---	9,090,630.21
	<b>Përqindje faktike të shpërndarjeve</b>	---	---	---	<b>21%</b>
	<b>Gjendja në llogari në fund të vitit financiar (lekë)</b>	---	---	---	12,152,196.57
	<b>Gjendja në llogari në fund të vitit financiar (valutë e huaj)</b>	---	---	---	36.83 euro
	<b>Numri i anëtarëve që kanë përfituar shpërblime</b>	---	---	---	Anëtarë- <b>47</b> Shpërndarje- <b>26</b>

Burimi: Të dhëna të vëna në dispozicion nga DDA.

*Kostot e administrimit të AAK – ve.*

Ligji Nr. 35/2016, i ndryshuar, parashikon se, shpenzimet totale të një AAK-je nuk mund të përbëjnë më shumë se 30 për qind të shpërblimeve të shpërndara. Shuma e përgjithshme e shpenzimeve të një shoqate apo çdo forme tjetër juridike OJF-je do të përfshijë edhe mjetet financiare të shpenzuara në përmirësimin e sistemit të administrimit dhe mbrojtjes së të drejtës së autorit<sup>42</sup>.

Ajo që lehtësisht evidentohet nga të dhënat e mësipërme, është niveli i lartë dhe ndjeshëm përtej normës së përcaktuar në ligj, të shpenzimeve administrative të AAK-ve, të cilat në raport me totalin e shpërblimeve të shpërndara, duhet të përfaqësojnë jo më shumë se 30% të kësaj vlere.



Sikurse shihet, kemi një luhatje ndërmjet vlerave, prej më të voglës, 21% të AAK – së F., për vitin 2022, deri tek më e larta, prej 8201% e regjistruar në aktivitetin e AKDIE, në vitin 2020.

Nga 13 vlera të këtij raporti, për periudhën e audituar, vetëm në dy raste, AAK – të, kanë respektuar përcaktimin ligjor sa i përket shpenzimeve administrative. Niveli i shpenzimeve të lejuara është lidhur me nivelin e shpërblimeve të shpërndara, me qëllim që administrimi dhe kostot e tij, të jenë totalisht në funksion të shpërndarjes së shpërblimeve tek mbajtësit e të drejtave të autorit. Por qartazi duket se AAK – të kanë shkelur këtë përcaktim ligjor.

Sa më lart evidentuar është vizualizuar nga Grafiku nr. 1, në katër nënseksionet e tij, për secilën AAK.

Grafiku nr. 3. Përqindja e shpenzimeve të administrimit të AAK – ve, në raport me shpërndarjet faktike për AAK – të.

<sup>42</sup> Ligji Nr. 35, datë 31.03.2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar, neni 151, paragrafi 5.



Burimi: Përpunuar nga Grupi i Auditimit mbi të dhënat e Tabelës nr. 4.

Në grafik, me ngjyrën blu paraqitet përqindja faktike e shpërndarjeve të kryera nga agjencitë e administrimit kolektiv sipas viteve, në raport me vlerën 30 % e paraqitur me ngjyrën portokalli. Përqindja faktike e shpërndarjeve të kryera nga një AAK përlogaritet si raport i shpenzimeve administrative kundrejt shpërndarjes faktike të shpërblimeve të mbajtësit e së drejtës. Sipas grafikut të mësipërm, vihet re një tendencë në rënie në raportin shpenzime/shpërndarje për agjencitë e administrimit kolektiv, por gjithsesi kostot e administrimit mbeten mbi normën e lejuar nga ligji për të drejtën e autorit, në raport me shpërndarjet faktike të ekzekutuara prej secilës AAK.


*Shpërndarja e shpërblimeve.*

Aspekti më i rëndësishëm i veprimtarisë së AAK – ve, lidhet me shpërndarjen e shpërblimeve për të drejtën e autorit tek mbajtësit e të drejtës, duke mos diskriminuar dhe përjashtuar asnjë autor, vepra e të cilit është përdorur nga subjekte të tjerë.

Përmbledhësja e veprimtarive financiare të AAK-ve, për periudhën 2019 – 2022, e paraqitur në Tabelën nr. 4, vë në dukje shtrirjen e shpërndarjes së shpërblimeve tek mbajtësit e të drejtës së autorit.

Për sa më sipër, agjencitë e administrimit kolektiv kanë kryer shpërndarje të mbajtësit e të drejtës së autorit, anëtarë të secilës agjenci, sipas grafikut të mëposhtëm:

Grafiku nr. 4. Numri i anëtarëve që kanë përfituar shpërblime për të drejtën e autorit sipas AAK-ve



*Burimi: Përpunuar nga Grupi i Auditimit mbi të dhënat e Tabelës nr. 4.*

Referuar të dhënave të Tabelës nr. 4, Agjencia FMAA, në vitin 2020 ka pasur 168 anëtarë dhe ka shpërndarë shpërblime për 131 prej tyre. Kjo agjenci, në vitin 2021 ka pasur një rritje të numrit të anëtarëve në 174, dhe për arsye të keqadministrimit, ka shpërndarë shpërblime vetëm për 72 prej anëtarëve të saj.

Agjencia “A.” në vitin 2020, ka pasur 219 anëtarë dhe ka shpërndarë shpërblime për 153 anëtarë. Kjo agjenci në vitin 2021 pavarësisht rritjes së numrit të anëtarëve në 254, ka shpërndarë shpërblime vetëm për 142 anëtarë.

Po e njëjta situatë vihet re tek administrimi i të drejtës së autorit nga agjencia e administrimit kolektiv AKDIE, e cila teksa në vitin 2019 kishte 413 anëtarë dhe shpërblente 372 prej tyre, në vitin 2020 pavarësisht se numri u rrit në 426, numri i anëtarëve përfitues pësoi një rënie drastike. Përfitues ishin vetëm 26 anëtarë të AKDIE.

Nga të dhënat e Tabelës nr. 4, lidhur me shpërndarjen e shpërblimeve, konstatohen dy dukuri:


*Së pari*, numri i përfituesve të shpërblimeve të së drejtës së autorit, mbetet shumë i ulët në raport me numrin e anëtarëve të AAK – ve.

*Së dyti*, konstatohet lehtësisht, që tendenca e rritjes së numrit të anëtarëve të agjencive, FMAA, A. dhe AKDIE, nuk është shoqëruar me rritje përpjestimore të numrit të anëtarëve që kanë përfituar shpërblim të së drejtës së autorit.

Nivelit i ulët i shpërndarjeve të shpërblimeve mbetet një shqetësim i trajtuar në të gjitha raportet e monitorimit që DDA – ja, ka prodhuar në mënyrë të përsëritur gjatë viteve 2019-2023.

Sa më lart e vënë në dukje, është vizualizuar nëpërmjet Grafikut nr. 3 dhe nënseksioneve, sipas AAK – ve FMAA, A., AKDIE dhe F.

Grafiku nr. 5 Numri i anëtarëve që kanë përfituar shpërblime dhe numri total i anëtarëve të AAK-së



Burimi: Përpunuar nga Grupi i Auditimit mbi të dhënat e Tabelës nr. 4.

Po ashtu, Grupi i Auditimit konstatoi se DDA - ja nuk ka evidencë e cila provon se AAK – të kanë përmbushur detyrimin ligjor lidhur me tarifat e shpërblimeve të mbledhura nga përdoruesit, të cilat në përfundim të vitit financiar nuk shpërndahen nga AAK-ja, të cilat duhet të depozitohen në një fond special për llogari të Ministrisë të Kulturës, në dispozicion të titullarëve të të drejtave të autorit për një periudhë 3-vjeçare.<sup>43</sup> Ky është një fenomen për të gjitha AAK – të.

#### Rishikimi i performancës së AAK – ve.

Procesi i administrimit të drejtës së autorit nga AAK – të, jo rigorozisht në përputhje me legjislacionin në fuqi, reflektohet edhe nga mungesa e rishikimit të performancës së AAK – ve, deri edhe për të metat e konstatuara gjatë proceseve të monitorimit të tyre nga DDA. Referuar përcaktimeve ligjore, asamblja e përgjithshme e anëtarëve të agjencisë duhet të mblidhet të paktën një herë në vit dhe ajo, veç të tjerash, e ka detyrë të rishikojë performancën e përgjithshme të organeve ekzekutive të AAK - së<sup>44</sup>.

Në përgjigje të pyetësorëve, lidhur me vendimet e marra nga asambljetë e përgjithshme të AAK-ve, për rishikimin e performancës së organeve ekzekutive të AAK - ve, GA – së i’u dha kjo përgjigje:

“...pas periudhave të monitorimit, shprehemi se për të metat e konstatuara nuk ka patur vendime të marra nga asambljetë e përgjithshme të AAK-ve, në lidhje me rishikimin e performancës së tyre të përgjithshme, të publikuara në faqet e internetit ose të përcjella pranë DDA-së”<sup>45</sup>.

Ndërkohë, Albautor shprehet se, nuk janë marrë vendime nga asambljetë e përgjithshme të AAK-së lidhur me rishikimin e performancës<sup>46</sup>.

<sup>43</sup> Ligji Nr. 35, datë 31.03.2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar, neni 151, paragrafi 9.

<sup>44</sup> Ligji Nr. 35, datë 31.03.2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar, neni 133, paragrafi 2, germa iii).

<sup>45</sup> Përgjigje e dates 02.10.2023, dhënë nga DDA, pyetësorit të datës 22.09.2023, përgatitur nga GA.

<sup>46</sup> Përgjigje e dates 29.09.2023, dhënë nga AAK Albautor, pyetësorit të datës 22.09.2023, përgatitur nga GA.

AAK – të gjatë aktivitetit të tyre nuk kujdesen të rishikojnë performancën e organeve të tyre ekzekutive.

### *SUADA*

Pyetësorit të përcjellë në fazë terreni më datë 22.09.2023, nëpërmjet DDA – së, SUADA i ktheu përgjigje (gjithnjë nëpërmjet DDA - së) vetëm katër pyetjeve të shtruara, pa ndonjë informacion të rëndësishëm, mbi aktivitetin e saj.

Grupit të Auditimit, në këto kushte, iu desh të vilte informacion nga burime të tjera, përfshirë raportet e gjeneruara nga DDA gjatë proceseve të monitorimit të SUADA – s.

Në shkresën nr. 3080 prot., datë 16.07.2020, të DDA – së, situata financiare e sportelit unik për vitin 2019, vlerësohet me probleme, sa i takon konstatimeve të përfshira në relacionin me nr. 4042/2 prot., datë 12.10.2020, sikurse vijon:

- Kostot e administrimit të SUADA gjatë vitit 2019 ishin në masën 171%, në raport me kufirin e lejuar dhe parashikuar me vendim të Bordit të Drejtorëve të SUADA datë 18.05.2018, ku ishte vendosur se “kostot e administrimit të SUADA nuk tejkalojnë 10%”;
- Për vitin 2019 Sporteli unik, SUADA ka vijuar të mos kryejë asnjë shpërndarje kundrejt agjencisë FMAA, duke bërë që gjendja në llogarinë bankarë të Sportelit Unik, SUADA në fund të vitit 2019 të ishte shumë e lartë.

Në relacionin nr. 2542/3 prot., i datës 02/06/2022 të DDA – së, lidhur me aktivitetin e ushtruar nga SUADA për vitin 2021, konstatohen problematikat si më poshtë:

- Nuk është rishikuar vendimi i Bordit të Drejtorëve të Sporteli Unik S.U.A.D.A., i datës 18.05.2018 lidhur me përqindjen e shpenzimeve administrative të Sportelit Unik.
- Nuk ka shpërndarë të ardhurat tek të gjitha AAK-të e licencuara sipas përqindjeve ligjore të përcaktuara në pikën 3, të nenit 138 të ligjit 35/2016.
- Nuk ka marrë masa për garantimin e transparencës në zbatim të Ligjit nr. 35/2016 dhe Udhëzimit nr. 663/2017.
- Nuk ka marrë masa për plotësimin e formularëve të autorizimit në pjesën B të formularit, lidhur me të dhënat e pagesës, të cilat duhet të përmbajnë dhe shumën konkrete të shpërblimit që duhet të paguhet nga përdoruesi sipas llogaritjes bazuar në metodologjinë e të ardhurave dhe tarifave të shpërblimit.

### *Përzgjedhja e subjekteve të cilët njoftohen zyrtarisht për t'u pajisur me autorizimin.*

Të dhënat e marra nga “Raporti i mbikëqyrjes së veprimtarisë financiare dhe administrative të Sportelit Unik për administrimin kolektiv të së drejtës së autorit për vitin financiar 2022”, vënë në dukje disa të meta, në aktivitetin e SUADA – s.

“Referuar, të dhënave të Qendrës Kombëtare të Biznesit, - thuhet në raport, janë 188 880 biznese aktive në Republikën e Shqipëri. Sporteli unik ka detyrimin të filtrojë këto të dhëna për të evidentuar të gjithë subjektet zbatues të ligjit për të drejtën e autorit. Sporteli unik duhet të garantojë se të gjithë subjektet përdorues trajtohen në mënyrë të barabartë për pajisjen me autorizimin përkatës. Është i qartë përkufizimi ligjor ku pajisja me autorizim është detyrim i subjekteve përdorues, megjithatë Sporteli unik duhet të jetë i organizuar dhe i paanshëm në dërgimin e njoftimeve tek subjektet”<sup>47</sup>.

Për Grupin e Auditimit (sikurse edhe për Drejtorinë e të Drejtës së Autorit, sipas dokumentacionit zyrtar të vënë në dispozicion), është e paqartë strategjia që SUADA ndjek në përzgjedhjen e subjekteve të cilët njoftohen zyrtarisht për t'u pajisur me autorizimin e të drejtës së autorit. Një relacion mbi strategjinë e ndjekur ka munguar deri tani. Për vitin 2022, SUADA depozitoi pranë DDA – së, një listë me 200 autorizime të lëshuara ndaj subjekteve përdorues, shifër tejet e vogël krahasuar me numrin e përdoruesve të veprave autoriale.

<sup>47</sup> Raporti i mbikëqyrjes së veprimtarisë financiare dhe administrative të Sportelit Unik për administrimin kolektiv të të drejtës së autorit për vitin financiar 2022

### *Proceset gjyqësore.*

Udhëzimi i Ministrisë së Kulturës, nr. 663 datë 10.10.2017, përcakton se, është përgjegjësi e SUADA – s, përmes Agjencisë drejtuese ndjekja e kryerjes së procedurave gjyqësore, administrative si dhe atyre të përmbarimit<sup>48</sup>. Sipas informacionit të vënë në dispozicion nga DDA, rezulton se, gjatë periudhës 2019 – 2022, SUADA ka iniciuar dhe ndjekur zhvillimin e dhjetë proceseve, me objekt shlyerjen e detyrimit të shpërblimit, nga ana e subjekteve përdorues të veprave me të drejtë autoriale, si më poshtë:

Tabela nr. 5. Proceset gjyqësore me objekt shlyerjen e detyrimeve që burojnë nga e drejta e autorit.

<b>Subjekti</b>	<b>Nipti</b>	<b>Ecuria e proceseve gjyqësore</b>
1. B.95 shpk	K.....K	Pushuar, pasi subjekti ka paguar detyrimin në llogarinë e SUADA.
2. B.H. P.F. (N. I.)	L.....Q	Pushuar, pasi subjekti ka paguar detyrimin në llogarinë e SUADA.
3. G. Shpk (Hotel T.I. and C.C.)	K.....O	Fituar Shkalla e Pare, Pritet të zbardhet Vendimi
4. K.Shpk	L.....S	Është në proces Gjyqësor në Shkallë të Parë
5. R. N. A. Shpk (Radio DJ)	L.....O	Është në proces në Shkallë të Parë. Subjekti pritet të paguajë detyrimin për t'u zgjidhur me ndërmjetësim
6. S. H. Shpk	L.....G	Pushuar
7. V.Shpk	L.....N	Është në proces, në fazat e fundit të shkallës së parë
8. Z.B. P.F. (Te Latini)	L.....K	Fituar Shkalla e Parë. Pritet të zbardhet Vendimi
9. Xh. shpk	J.....O	Është në proces drejt përfundimit të Shkallës së Parë
10. I. T.P.F. (La voglia)	L.....N	Është në proces në shkallë të parë

*Burimi: Të dhëna vënë në dispozicion nga DDA.*

Duke pasur parasysh se kushtet ekonomike, sociale dhe kulturore, të vendit tonë, nuk kanë maturuar një ndërgjegje të tillë ligjore dhe qytetare, ku e drejta e autorit të respektohet spontanisht dhe të mos çënohet rëndom, ky numër procesesh gjyqësore, rezulton shumë i vogël krahasuar me numrin e përdoruesve dhe abuzuesve potenciale dhe efektivë, me këtë të drejtë.

### *Ngritja e rrjetit të zyrave të përfaqësimit.*

Po ashtu, Udhëzimi Nr. 663 datë 10.10.2017 parashikon se, SUADA përmes Agjencisë drejtuese për realizimin e veprimtarisë së saj ngarkohet të përfundojë ngritjen e rrjetit të zyrave të përfaqësimit, me të paktën një zyrë në çdo qark, duke u kujdesur që mjediset e zgjedhura të jenë lehtësisht të arritshme, në vende të dukshme, me elemente të dallueshëm identifikues në mjediset e brendshme dhe të jashtme (tabela, logo, uniforma, etj) si dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme ku një staf profesional ofron të gjithë gamën e shërbimeve sa më eficiente, pa burokraci për subjektet përdorues.

Në rastet kur është e mundur, për realizimin e funksionit kolektiv të mbledhjes së të ardhurave, mund të shfrytëzohen edhe mjediset e Drejtorive Rajonale Kombëtare të Kulturës në territor si dhe ambiente të institucioneve të tjera në bazë të marrëveshjeve përkatëse.<sup>49</sup>

Në përgjigje të pyetësorëve, mbi arsytet që kanë penguar ngritjen e rrjetit të zyrave të përfaqësimit, SUADA shprehet se: “Sporteli Unik për Administrimin e të Drejtës së Autorit është e kufizuar në

<sup>48</sup> Udhëzimi Nr. 663 datë 10.10.2017 “Për mënyrën e funksionimit dhe të organizimit të Sportelit Unik për administrimin e të drejtës së autorit – SUADA në administrimin kolektiv”, kreu viii, paragrafi 2.

<sup>49</sup> Udhëzimi Nr. 663 datë 10.10.2017 “Për mënyrën e funksionimit dhe të organizimit të Sportelit Unik për administrimin e të drejtës së autorit – SUADA në administrimin kolektiv”, kreu vi, paragrafi 1 dhe 2.

buxhetin e saj vjetor dhe nuk ka mundësi financiare për të hapur zyra nëpër rrethe apo të shtojë stafin e saj duke qenë se të ardhurat nga shpërblimet e te drejtës së autorit nuk mund të mbulojnë rritjen e kostove administrative.<sup>50</sup>

Mosngritja e këtij rrjeti të zyrave të përfaqësimit të Sportelit Unik për Administrimin e te Drejtës së Autorit, vlerësohet si një tregues i keqadministrimit të SUADA – s.

### **Gjetje nga auditimi:**

1. Ministria e Kulturës ka rilicencuar agjencinë e administrimit kolektiv “A.”, në muajin gusht të vitit 2021, pa evidentuar shlyerjen e detyrimeve financiare prej 6,7 milion lekë të kësaj agjencie në fondin special të Ministrisë së Kulturës, kusht detyrues në Urdhrin<sup>51</sup> e ministrit “Për ripërtëritjen e licencës me kusht për agjencinë A.”. Nga Drejtoria e te Drejtës së Autorit pranë kësaj ministrie, nuk dokumentohet shlyerja e këtij detyrimi financiar.
2. Ministria e Kulturës nuk ka çelur një llogari të dedikuar, e cila të përdoret posaçërisht për krijimin e fondit special, ku duhet të depozitohen shumat e pashpërndara nga Agjencitë e Administrimit Kolektiv, mbajtësve të te drejtave të autorit.
3. Në kushtet e ndryshimeve të përfaqësuesve të administrimit të te drejtave të autorit , aktorëve të përfshirë, numrit të shtuar të përdoruesve, kategorive të te drejtave të paparashikuara më parë, konstatohet se nuk ka pasur një rishikim të metodologjisë dhe masës së tarifave të shpërblimit të veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit që nga viti 2017, nga grupet e interesit. Drejtoria për te Drejtën e Autorit, nuk ka bërë një analizë të thelluar mbi nevojën e rishikimit të metodologjisë dhe masës së tarifave të shpërblimit, si dhe nuk ka ndërgjegjësuar grupet e interesit mbi rëndësinë e saj.
4. Agjencitë e administrimit kolektiv:
  - nuk respektojnë mbajtjen brenda nivelit 30% të kostove të administrimit të te drejtave të autorit, në raport me masën e shpërblimeve të shpërndara tek mbajtësit e këtyre të drejtave;
  - kanë realizuar një nivel të ulët të shpërndarjeve të shpërblimeve, tek mbajtësit e te drejtave të autorëve;
  - nuk shpërndajnë tarifatat e shpërblimeve të mbledhura nga përdoruesit, të cilat në përfundim të vitit financiar, të cilat duhet të depozitohen në një fond special për llogari të Ministrisë së Kulturës, në dispozicion të titullarëve të te drejtave të autorit për një periudhë 3-vjeçare;
  - nuk rishikojnë performancën e përgjithshme të organeve ekzekutive të tyre.
5. SUADA:
  - nuk bën transparente kriteret e zbatuara nga ana e saj mbi përzgjedhjen e subjekteve të cilët njoftohen zyrtarisht për t’u pajisur me autorizimin e te drejtës së autorit;
  - gjatë periudhës 2019-2022, ka ngritur 10 akt-padi ndaj shkelësve të së drejtës së autorit, pra me një mesatare prej vetëm 2,5 shkelje të pretenduara të kësaj të drejte në çdo vit.
  - mbetet larg objektivit të gjurmimit dhe denoncimit të shkelësve të së drejtës së autorit;
  - nuk ka realizuar ngritjen e rrjetit të zyrave të përfaqësimit, me të paktën një zyrë në çdo qark.

### **Konkluzione:**

<sup>50</sup> Përgjigje e datës 29.09.2023, dhënë nga SUADA, pyetësorit të datës 22.09.2023, përgatitur nga GA.

<sup>51</sup> Urdhri nr. 432, datë 6.7.2018 “Për ripërtëritjen e licencës me kusht agjencisë ”Albautor” në administrimin kolektiv të te drejtave të autorëve të veprave artistike dhe letrare”

1. Mungesa e llogarisë të posaçme të Ministrisë së Kulturës, për Fondin Special si dhe mosdokumentimi i shlyerjes së detyrimit financiar prej 6,7 milion lekë të agjencisë A.në Fondin Special të Ministrisë së Kulturës, tregon neglizhencë dhe mosrespektim të detyrimeve ligjore midis palëve.
2. Mungesa e një analize të thelluar mbi nevojën e rishikimit të metodologjisë dhe masës së tarifave të shpërblimit, si dhe mosmarrja e masave për shkeljet e konstatuara në administrimin financiar të Agjencive të Administrimit Kolektiv, kanë krijuar kushte për abuzime dhe keqadministrim të së drejtës së autorit.
3. Mungesa e transparencës, në përzgjedhjen e subjekteve që njoftohen zyrtarisht për t'u pajisur me autorizimin e të drejtës së autorit, në gjurmimin dhe denoncimin e përdoruesve abuzivë të veprave, si dhe mosngritja e rrjetit të zyrave të përfaqësimit, kanë sjellë nivel të ulët të mbledhjes së tarifave nga përdoruesit, si dhe vështirësi në komunikimin dhe identifikimin e shkelësve të së drejtës së autorit.

#### **Rekomandime:**

1. Ministria e Kulturës dhe Drejtoria për të Drejtën e Autorit, të marrë masa për të analizuar dhe dokumentuar detyrimet e prapambetura financiare të Agjencive të Administrimit Kolektiv të të Drejtave të Autorëve duke plotësuar një databazë të dhënash financiare.  
*Menjëherë*
2. Ministria e Kulturës dhe Drejtoria për të Drejtën e Autorit të marrë masa t'i kërkojë Agjencisë së Administrimit Kolektiv "A.", dokumentimin e shlyerjes së detyrimit financiar prej 6,7 milion lekë që i takon mbajtësve të të drejtave të autorit, të përcaktuar në Urdhrin<sup>52</sup> e ministrit "Për ripërtëritjen e licencës me kusht për agjencinë A."  
*Menjëherë*
3. Ministria e Kulturës të krijojë Fondin Special, ku të depozitohen tarifat e shpërblimeve të mbledhura nga përdoruesit, të cilat në përfundim të vitit financiar nuk shpërndahen nga Agjencitë e Administrimit Kolektiv, duke çelur një llogari të dedikuar.  
*Menjëherë*
4. Drejtoria për të Drejtën e Autorit, të bëjë një analizë të thelluar mbi nevojën e rishikimit të metodologjisë dhe masës së tarifave të shpërblimit të së drejtës së autorit dhe t'a bëjë objekt konsultimi për grupet e interesit.  
*Menjëherë*
5. Drejtoria për të Drejtën e Autorit të propozojë masa administrative për agjencitë e administrimit kolektiv që:
  - tejkalojnë kostot e administrimit;
  - kanë nivel të ulët shpërndarjesh të shpërblimeve tek mbajtësit e të drejtës së autorit;
  - nuk rishikojnë performancën e aktivitetit të organeve ekzekutive të tyre;
  - nuk bëjnë transparente vendimet e tyre.*Menjëherë dhe në vijimësi*
6. Drejtoria për të Drejtën e Autorit t'i kërkojë Sportelit Unik për Administrimin e të Drejtës së Autorit, të bëjë transparente:
  - kriteret e zbatuara nga ana e saj, në përzgjedhjen e subjekteve që njofton zyrtarisht, për t'u pajisur me autorizim;
  - mënyrat e gjurmimit dhe denoncimit të shkelësve të së drejtës së autorit;
  - një analizë mbi mosngritjen e rrjetit të zyrave të përfaqësimit nga SUADA-s.

<sup>52</sup> Urdhri nr. 432, datë 6.7.2018 "Për ripërtëritjen e licencës me kusht agjencisë "Albautor" në administrimin kolektiv të të drejtave të autorëve të veprave artistike dhe letrare"


#### 4.2.2 A ka qenë efektiv procesi i mbikëqyrjes së administrimit kolektiv?

##### *Struktura e DDA-së*

Drejtoria për të Drejtën e Autorit (DDA), krijuar në bazë të ndryshimeve të Ligjit nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, është një transformim i Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit dhe funksionon si strukturë pranë Ministrisë së Kulturës, duke ushtruar veprimtarinë në zbatim të këtij ligji lidhur me mbikëqyrjen e veprimtarive të Agjencive të Administrimit Kolektiv, gjithashtu funksionon dhe si sekretariat teknik i Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit dhe Bordit të Arbitrazhit.

Drejtoria organizohet në dy sektorë, sektori i regjistrimit dhe sektori i monitorimit. Organigrama e kësaj drejtorie përbëhet: nga drejtori, përgjegjësi i sektorit të monitorimit dhe 4 specialistë, dy në sektorin e monitorimit dhe dy në atë të regjistrimit.

Skema nr. 7. Struktura e Drejtorisë për të Drejtën e Autorit



*Burimi: Përpunuar nga GA.*

Gjatë periudhës së auditimit 2019-2022, DDA-ja nuk ka funksionuar me strukturë të plotë. Me Urdhrin nr. 164, datë 5.10.2017 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Kulturës”, është miratuar organika që edhe sot nuk është plotësuar. Pozicioni i përgjegjës të sektorit të monitorimit aktualisht është vakant, që prej vitit 2017. Në sektorin e regjistrimit nuk ka në organigramë përgjegjës sektori dhe një pozicion në këtë sektor është vakant. Në situatën aktuale, ku detyrat e kësaj drejtorie kanë një fokus shumë të gjerë, kapacitetet institucionale të saj janë të pamjaftueshme jo vetëm për realizimin e objektivave, por dhe për mbikëqyrjen e aktivitetit të agjencive të administrimit kolektiv, gjë e cila përmendet dhe në përgjigjet e pyetësorëve të punonjësve të DDA-së. Për shkak të mungesës së stafit, ka një mbingarkesë të punonjësve, po ashtu, dhe profilet profesionale të tyre nuk janë në përputhje me nevojat e administrimit të së drejtës së autorit dhe monitorimin online, detyrim ky që mbetet për t’u përmbushur në të ardhmen.

##### *Statuti /Licenca e AAK-ve/ Procesi i licencimit*

Veprimtaria e agjencive të administrimit kolektiv (AAK) mbikëqyret nga Drejtoria për të Drejtën e Autorit (DDA).<sup>53</sup> Për qëllimet e kësaj mbikëqyrjeje, AAK-të paraqesin pranë DDA-së gjithë dokumentacionin e nevojshëm të administrimit të kësaj të drejte nga ana e tyre, si: statutin, rregulloren, kontratat dypalëshe dhe shumëpalëshe të lidhura me agjencitë e huaja të administrimit kolektiv, informacionin për personat që kanë autorizimin t’i përfaqësojnë, vendimet e organeve të tyre më të larta drejtuese dhe vendimmarrëse, raportin dhe bilancin e tyre vjetor, në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi, raportet e auditimit për veprimtarinë e tyre, të kryer nga auditues të brendshëm dhe/ose të jashtëm, të licencuar sipas dispozitave ligjore në fuqi, si edhe çdo dokument

<sup>53</sup> Neni 159 i Ligjit nr. 35/2016, i ndryshuar.

tjetër të nevojshëm për verifikimin e pajtueshmërisë së veprimtarive të agjencive me këtë ligj, dispozitat e tjera ligjore e nënligjore në fuqi dhe me statutet e tyre.

Gjatë periudhës 2019-2022, konstatohet se Drejtoria për të Drejtat e Autorit ka ushtruar kontrollet në këto agjenci<sup>54</sup>, ku një nga detyrimet e funksionimit të tyre lidhet me respektimin e licencave të dhëna nga Ministria e Kulturës. Në këto kushte, aktiviteti i ushtruar prej AAK-ve kufizohet brenda “kornizës” të licencës.

Licenca dhënë agjencisë A. me Urdhrin nr. 432 datë 06.07.2018 të ministrit të Kulturës, nuk ka mospërputhje me objektin statutor të miratuar për të, deri më 07.10. 2019.

Statuti i A. miratuar më datat 07.10.2019 dhe po ashtu, më datë 07.07.2022, në paragrafin 9 të nenit 6, parashikon: “Anëtarët e Asamblesë që bëjnë pjesë në këtë agjenci janë detyrimisht: kompozitorë, kantautorë, autorë teksti, përkthyes, aranzhatorë, piktorë, regjizorë, skenaristë, etj, apo dhe krijues të tjerë të cilët kanë lidhur kontratë me agjencinë dhe i kanë kaluar për administrim të drejtat”.

Licenca dhënë agjencisë A. me Urdhrin nr. 547, datë 30.08.2021, urdhëron: “Ripërtëritjen e licencës së shoqërisë “A. si agjenci e administrimit kolektiv në fushën e të drejtave të autorëve për veprat muzikore me apo pa tekst”, duke përcaktuar kështu një gamë kategorish të drejtash autori, që nuk janë në përputhje me parashikimet staturore.

Agjencia “A.”, e licencuar për ushtrim aktiviteti në fushën e administrimit kolektiv për kategorinë e të drejtave të autorit, për veprat muzikore me apo pa tekst, nuk ka reflektuar në lidhje ndryshimet e statutit, i cili ndryshe nga tagrat e licencës e legjitimon agjencinë të ushtrrojë aktivitetet edhe për të tjera kategori të drejtash.

Në lidhje me statutin e agjencisë “A.”, konstatimet e Drejtorisë për të Drejtat e Autorit, janë paraqitur DDA-ja, në memon me nr. 3993/5 prot. datë 18.8.2021 për aplikimin për ripërtëritje të licencës, dhe i njëjti konstatim, është përcjellë gjatë monitorimeve në vijim pranë agjencisë “A.”, nëpërmjet shkresave nr. 2097/7 prot., datë 6.6.2022 (për të metat e konstatuara nga monitorimi i vitit 2021) dhe nr. 1623/9 prot., datë 7.7.2023 (për të metat e konstatuara nga monitorimi i vitit 2022).

Dhe pse kjo drejtori ka vënë në dukje nevojën e ndryshimeve të statutit, sipas urdhrit të ministrit të Kulturës për ripërtëritjen e licencës, kjo agjenci ushtron aktivitetin e saj po në të njëjtat kushte.

Bazuar në pikën 4 të nenit 132, si dhe në germën a) të pikës 2 dhe pikën 5 të nenit 159, të ligjit, çdo propozim për ndryshimin e statutit është objekt i miratimit nga ministri përgjegjës për të drejtat e autorit, sipas propozimit të Drejtorisë për të Drejtën e Autorit dhe miratimi ose refuzimi i propozimit, duhet të jetë i argumentuar dhe të shprehet në lidhje me përputhshmërinë e ndryshimeve të statutit me ushtrimin e tagrave të licencës, objekt veprimtarie. Çdo ndryshim i statutit, i kryer në kundërshtim me parashikimet e kësaj pike, përbën kusht për heqjen e licencës së agjencisë së administrimit kolektiv.

Pavarësisht se DDA-ja ka monitoruar dhe ka lënë rekomandime për ndryshimet staturore lidhur me kategorinë e të drejtave që përfaqëson, AAK-ja “A.”<sup>55</sup>, asnjëherë nuk ka marrë masat e duhura për këtë proces, i cili finalizohet me ndryshimin e urdhrit të Ministrit të Kulturës, në lidhje me kategorinë e të drejtave që përfaqëson kjo agjenci dhe depozitimin e këtij miratimi në gjykatë. Kjo shkelje ligjore e konstatuar nga DDA-ja në raportet e saj të monitorimit, ka mbetur në kuadrin e rekomandimeve pa propozuar ndonjë masë administrative.

### *Kontrata me autorin*

Referuar pikës b) të nenit 159, të ligjit, kontratat dypalëshe dhe shumëpalëshe të lidhura me agjencitë e huaja të administrimit kolektiv janë pjesë e dosjes, ku bashkë me dokumentacionin e dorëzuar për licencime, mbikëqyrjen dhe kontrollohen nga DDA-ja, në përputhje me legjisllacionin në fuqi.

<sup>54</sup> Pika 5 neni 159

<sup>55</sup> Raportet “ Mbi mbikëqyrjen e veprimtarisë financiare dhe administrative të Agjencisë të Administrimit Kolektiv “Albautor” për vitet 2019, 2020, 2021, 2022.

Bazuar në raportet e mbikëqyrjes së veprimtarisë së AAK-ve, DDA-ja shprehet se “kontratat me autorin nuk kanë qenë pjesë e konstatimeve të saj”<sup>56</sup>, ndërkohë që kontratat verifikohen në procedurën e licencimit/rilicencimit të AAK-ve, i cili përfshin, në veçanti: autorizimin e autorit (i cili është pjesë e kontratës) për administrimin e të drejtave të tij, llojin e veprave dhe të drejtave për t’u administruar dhe kohëzgjatjen e kontratës, e cila nuk duhet të kalojë tre vite, e rinovueshme. Gjithashtu, AAK-të duhet të depozitojnë kontratat e reja të lidhura me autorët, gjatë kohës që janë të pajisur me licencë.

Licenca i jepet nga ministria përgjegjëse për të drejtat e autorit vetëm një subjekti (AAK) në lidhje me të njëjtën kategori të mbajtësve të së drejtës.

Bazuar në pikën 2 të nenit 135 të Ligjit nr. 35/2016, të ndryshuar, mbajtësit e të drejtave kanë të drejtë të zgjidhin autorizimin për të administruar të drejtat e tyre mbi veprën, dhënë prej tyre për një AAK, ose të tërheqin ndonjë prej të drejtave të tyre për të mos u administruar nga AAK-ja, në përputhje me nenin 132 të këtij ligji, për vendin e zgjedhur nga ana e tyre, duke bërë njoftimin e duhur, në formë të shkruar, jo më shumë se 6 muaj përpara. AAK-ja mund të vendosë që një zgjidhje ose tërheqje e tillë të hyjë në fuqi vetëm në përfundim të vitit financiar.

Ndërkohë, që në kontratat e AAK- së A., parashikohet se zgjidhja e kontratës bëhet me kërkesë me shkrim 6 muaj përpara përfundimit të kontratës. Pra, mbajtësve të së drejtës së autorit që të ndërpresin marrëdhënien me AAK – në, i’u njihet kjo e drejtë nëpërmjet njoftimit që bëhet mbi gjashtë muaj para. Kjo është në shkelje të ligjit për të drejtën e autorit.

AKDIE në kontratat e saj të lidhura me mbajtësit e të drejtës së autorit, parashikon se, kontrata zgjidhet me miratimin e palëve ose sipas shkaqeve ligjore, kur AKDIE mund të humbasë licencën apo është në fazën e likuidimit apo falimentimit. Këto kushte, nuk përcaktojnë afatin e njoftimit të vullnetit të tërheqjes nga kontrata dhe për më tepër e kushtëzojnë me rrethana ekstreme, sikurse ajo e heqjes së licencës dhe falimentimit.

Pavarësisht se palët janë të lira për të disponuar mbi të drejtat e tyre, kontratat duhet të rishikohen dhe unifikohen sa i përket afateve që ligji shprehimisht përcakton, mbi mundësinë e zgjidhjes së kontratës, duke garantuar trajtim të barabartë të të gjitha kategorive të të drejtave të autorit dhe mbajtësve të tyre.

#### *Pezullime/Heqje licence të agjencive të administrimit kolektiv*

Bazuar në nenin 159 të Ligjit nr. 35/2016, të ndryshuar, (ligji nr. 37/2022, datë 14.4.2022) në rastet kur DDA-ja konstaton se veprimtaria e AAK-së nuk është në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe dispozitat e tjera ligjore në fuqi, ose me vetë statutin e saj, në varësi të rrethanave, i propozon ministrit përgjegjës për të drejtat e autorit fillimin e procedurave për pezullimin për 6 muaj (3 muaj, sipas ndryshimeve të reja ligjore) të licencës, deri në heqjen e saj. Gjatë periudhës objekt auditimi, DDA-ja ka kryer monitorime, sikurse evidentuar në Aneksin Nr. 1, bashkëlidhur këtij pr/Raporti.

Në raportet dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion nga DDA-ja, konstatohen parregullsi të përsëritura në ushtrimin e aktivitetit të AAK-ve, gjatë periudhës së auditimit 2019-2022, si : tejkalimi i kostos administrative është jashtëzakonisht i lartë dhe nuk justifikohet në asnjë rrethanë, moskthimi i të ardhurave të shpenzuara pa të drejtë dhe rikthimin e këtyre të ardhurave për llogari të mbajtësve të të drejtave, mosrespektimi nga SUADA i vendimit Nr. 6 datë, 11.10.2018 të KKDA “Mbi shpërndarjen e pjesës takuese të shpërblimeve për anëtarët prodhues të ish-agjencisë së administrimit kolektiv për të drejtat e producentëve, AMP” duke mos kryer likuidimin e pagesave të shpërblimit kundrejt anëtarëve/prodhues të ish agjencisë AMP brenda datës 30.11.2018, dhe ka vijuar edhe për vitin 2019 të mos kryejë asnjë shpërndarje kundrejt agjencisë FMAA, niveli i ulët i shpërndarjeve, etj.

Agjencia “F.M.A.A.”, sipas kontratës, ka kaluar të drejtat në formë ekskluzive, që do të thotë se agjencia nuk ka të drejtë të kalojë të drejtat apo të lidhë marrëveshje me të njëjtin objekt. Neni 133 i ligjit për të drejtën e autorit parashikon se, agjencitë e administrimit kolektiv, në bazë të kontratës me autorin, me kërkesë të tij, mund të autorizojnë përdorimin e veprave te përdoruesit. Gjithashtu,

<sup>56</sup> Raportet e monitorimit të DDA-së, për vitet 2021 dhe 2022.

FMAA ka vepruar në kundërshtim të plotë me nenin 137 të ligjit, pasi AAK - të janë të autorizuar vetëm të japin autorizime për përdorim sipas kërkesave të përdoruesve, kontrata në formën jo ekskluzive për përdorimin e veprave, ose objekteve të të drejtave të lidhura, në këmbim të një shpërblimi, me kontratë të shkruar, brenda tagrave të përcaktuar në licencën e agjencisë. Kontrata mes palëve është lidhur që prej datës 10.12.2020, por është përcjellë pranë DDA përtej afateve<sup>57</sup>.

Drejtoria për të drejtën e Autorit, bazuar në rezultatet e raportit të monitorimit të veprimtarisë së FMAA-së, e cila nuk është në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe vetë statutin e saj, ndodhur në kushtet e nenit 159/1, pika 2, gërma a), c) dhe d) të ligjit nr. 35/2016, si dhe udhëzimin nr. 385, datë 13.10.2020 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për marrjen e licencës për administrimin kolektiv të të drejtave të autorit, ripërtëritjen e saj, si dhe përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për pezullimin dhe heqjen e licencës, në zbatim të Ligjit nr. 35/2016, i ndryshuar, ka propozuar në vitin 2023, heqjen e licencës së kësaj agjencie, për shkak se situata është jo vetëm e pandryshuar por edhe e përkeqësuar. Kjo situatë dëshmon joefektivitetin në aktivitetin mbikëqyrës të DDA-së dhe moszbatim të detyrimeve ligjore për pezullim/heqje licence. Kjo është jashtë periudhës së auditimit.

Për më tepër, Ministria e Kulturës në kundërshtim me ligjin ka kryer ripërtëritje licence me kusht për:

- Agjencinë AKDIE me Urdhrin nr. 434 datë 6.7.2018 “Për ripërtëritjen e licencës me kusht agjencisë ”AKDIE” në administrimin kolektiv të të drejtave të artistëve interpretues dhe ekzekutues”.
- Agjencinë A. me Urdhrin 26.5.2022 “Për ripërtëritjen e licencës me kusht agjencisë ”A.” në administrimin kolektiv të të drejtave të autorëve të veprave artistike dhe letrare.

#### *DDA/Sekretariat teknik*

Bazuar në pikën 3 të nenit 157 të ligjit për të drejtën e autorit, DDA-ja funksionon si sekretariat teknik i KKDA-së dhe Bordit të Arbitrazhit. Pranë DDA-së vepron një trupë arbitrimi, e përbërë nga 20 anëtarë, të emëruar çdo 3 vjet me urdhrë të ministrit përgjegjës për të drejtat e autorit. Përzgjedhja e tyre kryhet nga lista e ekspertëve me eksperiencë jo më të vogël se 10 vjet në fushën e së drejtës civile, e propozuar nga AAK-të, nga strukturat përfaqësuese të përdoruesve, si dhe nga subjektet e interesuara, propozime të cilat depozitohen pranë DDA-së, sipas afateve dhe modaliteteve të hartuara prej saj.

Gjatë periudhës së auditimit KKDA ka zhvilluar dy mbledhje, referuar:

- Vendimit nr. 9, datë 11.05.2020 të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit.
- Vendimit nr. 10, datë 29.06.2020 të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit.

Këto vendime janë të publikuara në faqen e website të MK, por për to nuk na u vunë në dispozicion procesverbalet e mbledhjeve të KKDA - së. Gjithashtu, Bordi i Arbitrazhit pranë DDA-së nuk është ngritur akoma.

#### **Gjetje nga auditimi:**

1. Drejtoria për të Drejtën e Autorit funksionon me strukturë jo të plotë dhe ka mungesë kapacitetesh institucionale. Kjo ka shkaktuar mbingarkesë pune në përmbushjen e detyrave funksionale dhe mosrealizimin në kohë të tyre. Për rrjedhojë procesi i mbikëqyrjes të aktivitetit të agjencive të administrimit kolektiv, ka qenë jo efektiv.
2. Drejtoria për të Drejtën e Autorit dhe pse ka lënë rekomandime për ndryshimet statutores të AAK-ja “A.”, statuti i së cilës nuk përputhet me licencën e dhënë nga Ministria e Kulturës, nuk ka marrë masat e duhura ligjore për ta finalizuar këtë proces. Kjo shkelje

---

<sup>57</sup> Raportet e DDA-së

ligjore e konstatuar nga DDA-ja në raportet e saj të monitorimit, ka mbetur në kuadrin e rekomandimeve, pa propozuar ndonjë masë administrative.

3. DDA-ja nuk ka verifikuar dhe mbikëqyrur kontratat e lidhura me mbajtësit e të drejtës së autorit, për zbatimin e kriterit kohor të njoftimit, që duhet t'i bëhet çdo mbajtësi të kësaj të drejte, mbi të drejtën e zgjidhjes së kontratës së autorizimit.
4. Ministria e Kulturës nuk ka nxjerrë asnjë akt administrativ për pezullim, apo heqje licence të aktivitetit të Agjencive të Administrimit Kolektiv të të Drejtave edhe pse janë konstatuar shkelje dhe parregullsi të përsëritura. Ministria e Kulturës ka kryer ripërtëritje licence me kusht, për agjencitë "AKDIE" dhe "A.", në kundërshtim me përcaktimet ligjore.
5. Në Drejtorinë e të Drejtës së Autorit në Ministrinë e Kulturës, nuk është ngritur Bordi i Arbitrazhit, i cili shërben si organ kolegjal për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve, që janë grupet e interesit të drejtave të autorit.
6. Drejtorja e të Drejtës së Autorit në cilësinë e sekretariatit teknik të Këshillit Kombëtar të të Drejtës së Autorit, nuk ka mbajtur procesverbale për dy mbledhjet e zhvilluara nga ky këshill.

#### **Konkluzione:**

1. Në kushtet kur Shqipëria është në proces të anëtarësimit në BE dhe si e tillë do të duhet të përgjigjet me kapacitetet njerëzore dhe profesionale për të garantuar zbatimin dhe mbrojtjen e të drejtave të autorit, struktura e plotë dhe efektive e DDA-së është domosdoshmëri për mbikëqyrjen e aktivitetit të AAK-ve dhe realizimin e detyrave objektive.
2. Në kushtet kur ligji për të drejtën e autorit është një ligj relativisht i ri dhe kërkon kohën e vet për t'u përvetësuar në kuptim të zbatimit dhe plotësimit të tij me aktet e nevojshme nënligjore, DDA-ja si e vetmja strukturë ligjore që garanton mbrojtjen e të drejtës së autorit, duhet të luajë rolin kryesor në mirëadministrimin e kësaj të drejte, jo vetëm në rolin korrigjues, por dhe ndëshkues duke mbajtur në vëmendje aktorin më të rëndësishëm, mbajtësin e të drejtës. Marrja e masave administrative për respektimin e detyrimeve ligjore nga AAK-të, të cilat operojnë në mënyrë të përsëritur në shkelje të ligjit, do të shmangi abuzimet nga ana e tyre, do të rrisë jo vetëm reputacionin e institucioneve përfaqësuese, por dhe besimin e mbajtësve të të drejtave, të cilët e kanë pranuar këtë mënyrë administrimi.
3. Funksionimi i DDA-së në cilësinë e sekretariatit teknik të KKDA-së dhe Bordit të Arbitrazhit, ndikon në miradministrimin e proceseve lidhur me mbikëqyrjen e AAK-ve. Mospërcaktimi ligjor i afatit kohor për ndërhyrjen e KKDA-së, si një organ vendimmarrës, ka sjellë zvarritje të procesit lidhur, jo vetëm me metodologjinë dhe masën e tarifave të shpërblimit, por dhe me problematikat e tjera të administrimit të AAK-ve.

#### **Rekomandime:**

1. Ministria e Kulturës të plotësojë organikën e miratuar për strukturën e Drejtorisë për të Drejtën e Autorit.

*Menjëherë*

2. Ministria e Kulturës:
  - t'i kërkojë AAK -së "Albautor", fillimin e procedurës së ndryshimit të statutit, në përputhje me licencën;
  - të rishikojë kushtet e kontratave të lidhura nga AAK-të me mbajtësit e të drejtave;

- për të gjitha AAK-të tek të cilat janë konstatuar shkelje ligjore dhe parregullsi të përsëritura,  
të fillojë procedurën për pezullim, apo heqje licence.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

3. Ministria e Kulturës, të marrë masa për ngritjen e Bordit të Arbitrazhit, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve.

*Menjëherë*

4. Ministria e Kulturës të marrë masat për monitorimin e aktivitetit të Këshillit Kombëtar, për të Drejtën e Autorit dhe të dokumentojë me procesverbale, çdo mbledhje të zhvilluar.


*Menjëherë*

#### 4.3 A ka funksionuar koordinimi dhe inspektimi ndërmjet DDA, AMA dhe ISHMT?

Diversiteti i krijimtarisë njerëzore dhe krijimtarisë, si dhe konvergencat e mbrojtjes së tyre ligjore e bëjnë sistemin e pronësisë intelektuale një domosdoshmëri për zbatimin efektiv të rezultateve të veprimtarisë krijuese njerëzore. Kjo nënvizon domosdoshmërinë e menaxhimit të përshtatshëm të tërësisë së krijimit dhe / ose marrjes së rezultateve intelektuale të punës njerëzore dhe përdorimin efektiv të tyre.<sup>1</sup>

Koordinimi ndërinstytucional ndërmjet Drejtorisë për të Drejtën e Autorit, Autoritetit të Medias Audiovizive dhe Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut është një domosdoshmëri për garantimin e mbrojtjes së të drejtës së autorit në Shqipëri.  
Skema nr. 7.

KUADRI INSTITUCIONAL I PRONËSISË INTELLEKTUALE NË RSH



Referuar skemës sa më sipër, auditimi për garantimin e mbrojtjes së të drejtës së autorit është fokusuar në koordinimin e veprimtarisë së tre subjekteve, të cilat sipas funksionit që kanë, duhet të sigurojnë mbrojtjen e të drejtave të autorëve.

Këto subjekte janë përkatësisht DDA- Drejtoria për të Drejtën e Autorit, strukturë pranë Ministrisë së Kulturës e cila është përgjegjëse për të drejtat e autorit dhe ushtron veprimtarinë në bazë dhe për zbatim të ligjit për të drejtën e autorit.

Deri para ndryshimit të strukturës së saj, kjo Drejtoria kishte status juridik si Zyra Shqiptare për të Drejtën e Autorit, ku pjesë e saj ishte edhe struktura e inspektimit të subjekteve përdoruese të së drejtës së autorit.

Sot kjo strukturë inspektimi i ka kaluar Inspektoratit Shtetëror të Tregut, që është në varësi të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë, në të cilën ka një sektor për të drejtën e autorit.

Nga ana tjetër, Autoriteti i Mediave Audiovizive, është organi rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në Republikën e Shqipërisë, institucion i cili bazuar në ligjin organik nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ka si detyrë funksionale të sigurojë nga ana e ofruesve të

shërbimit mediatik audioviziv, respektimin e së drejtës së autorit dhe në veçanti të drejtës së transmetimit, si pjesë e pronësisë intelektuale.

Sa i përket koordinimit ndërinstitucional midis aktorëve të përfshirë në procesin e mbrojtjes së të drejtës së autorit Drejtoria e të Drejtës së Autorit, shprehet se ligji i të drejtës së autorit i cili krijon strukturat më të rëndësishme për politikëbërje dhe ligjzbatuese, përsëri nuk është i qartë në lidhje me zbatimin e të drejtës së autorit.

Në ligjin për të drejtën e autorit, Drejtoria për të Drejtën e Autorit propozon, harton dhe zbaton strategjinë dhe politikën e duhur për mbrojtjen, ushtrimin dhe zbatimin e së drejtës së autorit, të drejtave të lidhura me të dhe të drejtave të tjera që mbrohen nga ky ligj, në përputhje me detyrimet ndërkombëtare, legjislacionin vendas dhe interesat përkatës kombëtarë të Republikës së Shqipërisë; propozon akte ligjore lidhur me mbrojtjen, ushtrimin dhe zbatimin e së drejtës së autorit, të drejtave të lidhura me të dhe të së drejtave të tjera, që mbrohen nga ky ligj.

Ndërkohë po në këtë ligj përcaktohet se mbikëqyrja dhe inspektimi për zbatimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura bëhet në përputhje me ligjin për inspektimin nga inspektorati që mbulon fushën e mbikëqyrjes së tregut, pranë ministrisë përgjegjëse për tregtinë.

Gjithashtu, ligji aktualisht nuk përcakton dispozita në lidhje me kontrollin dhe mbikëqyrjen në fushën digjitale të së drejtës së autorit, një domosdoshmëri në kushtet e reja të zbatimit të së drejtës së autorit. Së fundi, ligji nuk ka dispozitë autorizuese në lidhje me përgjegjësitë për kontrollin e zbatimit të ligjit nga OSHMA-të. Kjo përgjegjësi parashikohet në ligjin organik të AMA, por është mangësi në ligjin thelbësor të së drejtës së autorit. Pra siç vihet re ka një paqartësi në kompetencat institucionale të Drejtorisë së të Drejtës së Autorit mbi kontrollin e zbatimit të ligjit nga Ofruesit e Shërbimeve Mediatike Audiovizuale (OSHMA).

-Sa i përket koordinimit institucional ISHMT – DDA, Inspektorati Shtetëror për Mbikëqyrjen e Tregut, në përgjigjet zyrtare sqaron se: “Janë realizuar takime me DDA-në, shkëmbime të dhënash, trajnime për forcimin e kapaciteteve dhe aktivitete në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të autorit”. Midis ISHMT-së dhe DDA-së është nënshkruar dhe një marrëveshje në vitin 2022, megjithatë nga auditimi konstatohet se në këtë marrëveshje, nuk përcaktohen qartë modalitetet e fushëveprimit dhe bashkëpunimit apo inspektime të përbashkëta midis këtyre dy strukturave.

Në mangësitë që ISHMT përmend gjatë funksionit inspektues, është numri i pamjaftueshëm i inspektimeve.

Të dhënat statistikore janë për përdoruesit e veprave audio-vizuale pasi edhe muzika është pjesë e tyre. Subjektet përdorues janë kryesisht hotele, bar/restorante, klube verore, radio, televizione.

Masat administrative janë:

2019: 21 gjoba + 4 paralajmërime

2020: 2 gjoba + 2 paralajmërime

2021: 41 gjoba + 6 paralajmërime

2022: 20 gjoba + 5 paralajmërime

Numri i inspektimeve është i pamjaftueshëm sepse ligji nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar, parashikon 12 lloje të objekteve që synohen të mbrohen. Gjithashtu, ISHMT-ja vepron në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, prandaj 9 inspektorë nuk janë të mjaftueshëm për rritjen e numrit dhe zgjerimin e objektit të inspektimeve. Ky institucion ka mangësi edhe në logjistikën e transportit, për lëvizjet e inspektorëve nëpër rrethe.

AMA – Autoriteti i Medias Audiovizive, në përgjigjet e saj zyrtare mbi qartësinë e kompetencave dhe fushëveprimit të saj në mbrojtjen dhe garantimin e të drejtës së autorit, sqaron se është vetëm një ndër institucionet e ngarkuara me monitorimin e zbatimit të detyrimit për inspektimin e OSHMA-ve pasi mbikëqyrjen e kryejnë institucione të tjera publike, të tilla si: Drejtoria e të Drejtave të Autorit (Ministria e Kulturës) dhe ISHMT.

AMA, me shkresën nr. 2598 prot., datë 27.07.2021 i ka bërë një kërkesë për sqarim Ministrisë së Kulturës mbi të drejtat e transmetimit që disponon S.U.A.D.A (Sporteli Unik Administrues i të Drejtës së Autorit) për territorin e vendit. Ministria e Kulturës me shkresën nr. 2598/1 prot., AMA

datë 04.08.2021 ka kthyer përgjigje ku ndër të tjera në pikën katër të saj saktëson që :“neni 178 i ligjit për të drejtën e autorit parashikon se Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, kontrollon zbatimin e këtij ligji në tregun e brendshëm në përputhje me ligjin nr. 10 433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. Sa më sipër, kompetencat për inspektimin e OSHMA-ve për këto të drejta i ka ISHMT. Pra, AMA nuk mund të kontrollojë dhe të sanksionojë një subjekt për të njëjtën kundërvajtje administrative dy herë.

Nga auditimi i kryer në terren, grupi i auditimit konstatoi se në lidhje me veprimtarinë inspektuese, Drejtoria e Mbikëqyrjes në AMA, gjatë vitit 2021 ka kryer 118 inspektime në të gjithë territorin e vendit. Ndërsa në vitin 2022, përmes grupeve të veta të inspektimit, ka ushtruar 249 kontrolle të aktivitetit të OSHMA-ve. Nga këto, 134 janë inspektime të OSHMA-ve dhe 177 janë monitorime në terren. Kontrollat kryesisht janë kryer për respektimin e të drejtës së transmetimit, si dhe të monitorimit të sinjalit audioviziv.

Në lidhje me koordinimin ndërinstitucional, AMA dhe AKEP, në datën 03.11.2021, kanë nënshkruar një memorandum bashkëpunimi midis tyre, ku në vitet 2022 dhe 2023 kanë ngritur grupe të përbashkëta inspektimi. Kontrollat e kryera kanë qenë kryesisht ndaj subjekteve ISP, me fokus piraterinë televizive që kryhet nëpërmjet internetit.

Në përgjigjet e saj zyrtare AMA sqaron se, janë zhvilluar një sërë takimesh midis saj dhe Sportelit Unik të Administrimit të të Drejtës së Autorit, ku më i fundit është ai i zhvilluar me datë 17.03.2022, pjesë e takimit të të cilit ishin dhe Drejtori i Drejtorisë për të Drejtën e Autorit në Ministrinë e Kulturës dhe Inspektorati Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut me Kryeinspektorin.

Gjithashtu prezent ishte dhe shoqata e subjekteve kabllore RRTL. Gjatë këtij takimi u paraqitën një sërë pretendimesh nga shoqatat kabllore, ku më i rëndësishmi ishte përcaktimi i metodologjisë nga SUADA për kryerjen e pagesave. Gjithashtu një pretendim tjetër i tyre, ishte mbi kontrollin nga ana e Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes, për subjektet të paautorizuara nga AMA, për të drejtën e autorit. Gjatë takimit të kryer, përveç problematikës së shfaqur nga RRTL mbi çmimin e pagesave, një problematikë tjetër që u shfaq në mbledhje ishte dhe ajo e kontrollit të subjekteve të cilat nuk kryenin pagesat vjetore. Pas shfaqjes së këtij problemi nga përfaqësuesit e Sportelit Unik të Administrimit të të Drejtës së Autorit, përfaqësuesi i Autoritetit të Mediave Audiovizive, sqaroi se në bazë të neni 178, të ligjit për të drejtën e autorit, kontrolli dhe zbatimin e këtij ligji është kompetencë e Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut.

Autoriteti i Medias Audiovizuale, në kuadër të respektimit të dispozitës ligjore të parashikuar në ligjin e saj organik<sup>58</sup>, i kërkon çdo Ofruesi të Shërbimeve të Medias Audiovizuale, respektimin e të drejtës së autorit dhe të drejtat e lidhura me të.

Në këtë kuadër, AMA, në rregulloret e saj të dhënies së licencave për subjektet audio dhe /ose audiovizive ka të përcaktuar detyrimin e këtyre subjekteve për paraqitjen e dokumentacionit që vërteton të drejtat e transmetimit të veprave artistike. Në rast mosparaqitjeje të këtij dokumenti, subjekti nuk pajiset me licencë transmetimi. Në shumicën e rasteve subjektet sjellin kontratë marrëveshje me S.U.A.D.A-n, sa i përket këtyre të drejtave.

Pra në periudhën e licencimit apo rilicencimit, një ndër kriteret që i kërkohet subjekteve është depozitimi i marrëveshjeve për të drejtat e transmetimit. Gjithashtu çdo fillim viti, subjektet audio ose audiovizive lajmërohen nga AMA, mbi respektimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura me to, duke i drejtuar këto subjekte në lidhjen e kontratë/marrëveshjeve me SUADA-n.

Në vitin 2021, AMA, ka ngritur sistemin e qendëruar të monitorimit në 12 qarqet e vendit për monitorimin e sinjalit audio FM/radio.

Në bashkëpunim me RTSH-në, sistemi u vendos në pikat transmetuese të RTSH-së dhe kontrolli kryhet nga zyrat qendrore të AMA-s në Tiranë. Funkzioni kryesor i këtij sistemi është monitorimi në kohë reale i cilësisë së sinjalit transmetues të radiove si dhe regjistrimi i programacionit që ai transmeton. Gjithashtu AMA, në bashkëpunim me Komisionin e Integritit European, ka filluar një procedurë ku synimi kryesor i saj është modernizimi i studios së monitorimit dhe regjistrimit në AMA. Sa i përket kësaj procedure, nga KIE, është sjellë një ekspert i jashtëm i cili ka bërë

<sup>58</sup> ligjin nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”

vlerësimin në terren të kushteve teknike të studios si dhe janë nxjerrë kriteret e nevojshme për studion e re që nevojitet. Duke qenë se kosto për implementimin e këtij projekti është e lartë, dhe kapacitetet financiare të AMA-s janë të reduktuara, janë në pritje që në bashkëpunim me KIE të gjendet një donator i jashtëm, i cili mund të financojë këtë projekt.

Referuar kapaciteteve monitoruese, AMA ka një kapacitet monitorues/regjistruar për vetëm 48 programe/kanale, nga të cilat 12 kanale janë të dubluara për arsye sigurie. Këto programe janë kryesisht programe që transmetohen nga vendndodhja Tiranë-Durrës (pika transmetuese e fushë Dajtit), pra kanale që transmetohen në formatin DVB-T2 pa pagesë. Pra aktualisht mund të regjistrohen dhe të mbahen në arkiv 36 kanale (48-12). Numri i kanaleve televizive që transmetohen në platformat me pagesë dhe pa pagesë në vendin tonë është përafërsisht 140 kanale. Numri i punonjësve të Drejtorisë së Monitorimit dhe Analizës aktualisht është 11 punonjës.

1. Fokusi kryesor është monitorimi i programeve informative të operatorëve radiotelevizivë kombëtarë dhe sipas rastit dhe ato lokalë dhe rajonalë.

2. Monitorimi tematik i programeve dhe reklamave të transmetuara nga OSHMA-të, duke ia raportuar AMA-s konstatimet sipas rastit. Gjithashtu monitoron të drejtat e transmetimit kryesisht për eventet sportive dhe ato artistike (filma, dokumentarë) të platformave me pagesë.

Pra siç evidentohet monitorimi, nuk është për çdo program të çdo OSHMA-je, në rang kombëtar, por tematik, referuar numrit të pamjaftueshëm të monitoruesve dhe mungesës logjistike dhe fondeve.

Referuar kapaciteteve logjistike të AMA, në nivel zyrash qendrore dhe vendore, sa i përket monitorimit të programeve televizive të OSHMA-ve, AMA, ka vetëm një zyrë dhe ajo ndodhet në Tiranë dhe nuk ka zyra të tjera të shpërndara nëpër rrethe. Sfida kryesore që ka AMA në vitet në vijim sa i përket kësaj fushe (të drejtë transmetimi dhe autori), është rritja e kapaciteteve monitoruese me ndërtimin e një studio të monitorimi si dhe trajnimit të stafit me përshtatjen e sistemeve të reja teknologjike dhe posedimi i këtyre sistemeve. Pra rritja e mundësisë për të ecur paralelisht në kohë me ndryshimet e vullshme teknologjike që po ndodhin në sektorin audiovizual.

#### **Gjetje nga auditimi:**

1. Paqartësia e kompetencave institucionale ndërmjet subjekteve: Drejtoria për të Drejtën e Autorit, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut dhe Autoritetit të Mediave Audiovizuale, të ngarkuara me mbrojtjen dhe garantimin e së të drejtës së autorit, ka sjellë koordinim të pamjaftueshëm të veprimeve të tyre, për respektimin e kësaj të drejte.

#### **Konkluzione:**

1. Koordinimi ndërinstytucional midis Ministrisë së Kulturës si institucioni politik bërës, Drejtorisë për të Drejtën e Autorit, Inspektoratit Shtetëror dhe Mbikëqyrjes së Tregut dhe Autoritetit të Medias Audiovizive, për marrjen e iniciativave të duhura për ndryshimet ligjore, ka qenë i pamjaftueshëm. Për rrjedhojë ka mangësi në kuptimin dhe qartësimin e kompetencave monitoruese dhe inspektuese midis institucioneve përgjegjëse, për të garantuar mbrojtjen e të drejtës së autorit.

#### **Rekomandime:**

1. Drejtoria për të Drejtën e Autorit, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut dhe Autoriteti i Mediave Audiovizive, të marrin masa për të bashkërenduar, veprimet ndërinstytucionale, për garantimin e procesit të respektimit të së drejtës së autorit.

*Menjëherë*

## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**



## **SHTOJCA NR.1**

### Monitorimi për vitin 2019:

1. Relacion mbi gjendjen financiare të agjencive të administrimit kolektiv dhe sportelit unik për vitin 2019, nr. 4042/2 prot., datë 12.10.2020;
2. Urdhër grupi i punës nr. 357 datë 23.9.2020 i Ministrit të Kulturës “Për ngritjen e grupit të punës për ushtrimin e kontrollit mbi të gjitha aspektet ekonomike dhe ligjore të Sportelit Unik SUADA dhe Agjencive të Administrimit Kolektiv për vitin 2019”
3. Shkresa nr. 2250 prot., datë 6.7.2020, kërkesë agjencisë “A.” për depozitimin e dokumentacionit;
4. Shkresa nr. 3097 prot., datë 17.7.2020 Agjencia A. ka depozituar dokumentacionin;
5. Shkresa nr. 2250 prot., datë 6.7.2020 kërkesë agjencisë FMAA për depozitim dokumentacioni;
6. Shkresa nr. 2993 prot., datë 10.7.2020 agjencia “FMAA” ka përcjellë informacionin;
7. Shkresa nr. 2250 prot., datë 6.7.2020 kërkesë agjencisë “AKDIE” për depozitim dokumentacioni
8. Shkresa nr. 2951 prot., datë 9.7.2020 agjencia “Akdie” ka përcjellë informacionin;
9. Sporteli Unik ka përcjellë dokumentacionin me shkresën nr. 3080 prot., datë 16.7.2020.

### Aplikim për ripërtëritje të licencës për vitin 2021 dhe përfshin edhe monitorimin e vitit 2020

1. Memo nr. 3993/7 prot., datë 20.8.2021 “Mbi aplikimin për ripërtëritje të licencës si agjenci e administrimit kolektiv për shoqërinë “Agjencisë së Administrimit Kolektiv të të Drejtave të Artistëve Interpretues/Ekzekutues “AKDIE”;
2. Memo nr. 3993/6 prot., datë 19.8.2021 “Mbi aplikimin për ripërtëritje të licencës si agjenci e administrimit kolektiv për shoqërinë “Agjencia e Administrimit Kolektiv të të Drejtave të Autorëve në fushën e Kinematografisë dhe të veprave të tjera Audiovizuale Forumi i Mbrojtjes së Producentëve dhe Autorëve –Film&Video”-“FMAA”;
3. Memo nr. 3993/5 prot., datë 18.8.2021 “Mbi aplikimin për ripërtëritje të licencës si agjenci e administrimit kolektiv për shoqërinë “A.”;
4. Raport i grupit të punës nr. 6002/2 prot., datë 13.12.2021 “Mbi monitorimin e veprimtarisë së Sportelit Unik S.U.A.D.A”

### Monitorimi për vitin 2021:

1. Shkresa nr. 2097/1 prot., datë 12.4.2022, kërkesë për depozitim dokumentacioni për agjencitë “A.”, “FMAA”, “AKDIE”;
2. Shkresë nr. 1503/2 prot., datë 12.4.2022, kërkesë për depozitim dokumentacioni për agjencinë “F.”;
3. Shkresë nr. 2097 prot., datë 12.4.2022, kërkesë për depozitim dokumentacioni për Sportelin Unik;
4. Memo nr. 1503/1 prot., datë 12.4.2022, plotësimi i dokumentacionit nga agjencia “F.”
5. Relacion i monitorimit nr. 2542/3 prot., datë 2.6.2022,
6. Shkresë nr. 2097/6 prot., datë 6.6.2022, për përfundimin e procedurës së monitorimit për agjencinë “F.”;
7. Shkresë nr. 2097/9 prot., datë 6.6.2022, për përfundimin e procedurës së monitorimit për agjencinë “Akdie”;
8. Shkresë nr. 2097/8 prot., datë 6.6.2022, për përfundimin e procedurës së monitorimit për agjencinë “FMAA”;
9. Shkresë nr. 2097/7 prot., datë 6.6.2022, për përfundimin e procedurës së monitorimit për agjencinë “A.”;
10. Shkresë nr. 2097/5 prot., datë 6.6.2022, për përfundimin e procedurës së monitorimit për Sportelin Unik.
11. Shkresë nr. 2542/6 prot., datë 6.6.2022, kërkesë për marrjen e masave administrative për Agjencinë A., drejtuar ISHMT-së;

12. Shkresë nr. 2542/5 prot., datë 6.6.2022, kërkesë për marrjen e masave administrative për Agjencinë FMAA, drejtuar ISHMT-së;
  13. Shkresë nr. 2542/4 prot., datë 6.6.2022, kërkesë për marrjen e masave administrative për Agjencinë Akdie, drejtuar ISHMT-së
- Agjencia "A." ka depozituar dokumentacionin me shkresën nr. 2336 prot., datë 22.4.2022;  
 Agjencia "FMAA" ka përcjellë 2352 prot., datë 26.4.2022 ka përcjellë dokumentacionin;  
 Agjencia "AKDIE" me shkresën nr. 2097/2 prot., datë 22.4.2022 ka përcjellë dokumentacionin;  
 Agjencia "F.", me shkresën nr. 1389 prot., datë 31.3.2022 ka përcjellë pasqyrat financiare dhe me shkresën nr. 1503/3 prot., datë 21.4.2022 ka përcjellë dokumentacionin e kërkuar nga Ministria;  
 Sporteli Unik me shkresën nr. 2097/3 prot., datë 10.5.2022 ka përcjellë dokumentacionin.

#### Monitorimi për vitin 2022:

1. Me anë të shkresës nr. 1623 prot., datë 3.4.2023, janë njoftuar AAK-të për fillimin e procedurës së kontrollit;
2. Me anë të shkresës nr. 1622 prot., datë 3.4.2023, është njoftuar Sporteli Unik për fillimin e procedurës së kontrollit;
3. Njoftim për takim me AAK-të dhe Sportelin Unik, nr. 1623/2 prot., datë 15.5.2023;
4. Memo mbi raportet e DDA nr. 1622/1 prot., datë 2.6.2023;
5. Raporti nr. 1622/2 prot., 2.6.2023 i Sportelit Unik, nr. 1623/3 prot., 2.6.2023 i Faber, nr. 1623/4 prot., 2.6.2023 i AKDIE, nr. 1623/5 prot., 2.6.2023 i Albautor, nr. 1623/6 prot., 2.6.2023 i FMAA;
6. Shkresë përcjellëse, nr. 1622/3 prot., datë 7.7.2023 Sporteli Unik, nr. 1623/7 prot., datë 7.7.2023 FMAA, nr. 1623/8 prot., datë 7.7.2023 AKDIE, nr. 1623/9 prot., datë 7.7.2023 A., nr. 1623/10 prot., datë 7.7.2023 F..
7. Memo nr. 3995 prot., datë 31.7.2023 për ngritjen e grupit të punës për FMAA.
8. Urdhër i Ministrisë të Kulturës nr. 480, datë 31.7.2023, për ngritjen e grupit të punës.

#### Sporteli Unik

1. Shkresa nr. 217 prot., date 31.3.2023, depozitim informacioni.

#### F.

1. Shkresa nr. 1615 prot., date 31.3.2023, bilancin vjetor;
2. Shkresa nr. 1623/1 prot., date 18.4.2023, shkresë informuese mbi ndryshimin e selisë, vërtetimin e gjykatës, kërkesën e Faber për regjistrim të vendimit të gjykatës;
3. Shkresa nr. 2765 prot., date 26.5.2023, dokumentacion shtese.

#### Akdie

1. Shkresa nr. 1450 prot., datë 23.3.2023 dokumentacioni shoqërues për procedurën e monitorimit;
2. Shpjegime dhe informacione shtesë pas mbledhjes së datës 17.5.2023, nëpërmjet postës elektronike datë 26.5.2023.

#### A.

1. Shkresa nr. 1616 prot., datë 31.3.2023, raportin vjetor dhe dokumentacionin shoqërues;
2. Shkresa nr. 2766 prot., datë 26.5.2023, shpjegime dhe plotësim dokumentacioni.

#### FMMA

1. Shkresa nr. 2133 prot., datë 3.5.2023, raporti vjetor dhe dokumentacioni shoqërues;
2. Shkresa nr. 2681 prot., datë 24.5.2023, dokumentacioni plotësues.